



COOPERATION AND DEVELOPMENT INSTITUTE

PROGRAMMI I ZONES FUNKSIONALE - BASHKIA E RE DURRES -

Instituti për Bashkëpunim dhe Zhvillim – Cooperation and Development Institute

Rr. Sulejman Delvina, Pall. Moskat, Shk.8-64, 1019, Tirana – Albania

T/F: +355 4 2203054 E: info@cdinstitute.eu W . <http://www.cdinstitute.eu>; <http://www.shtetiweb.org>

TABELA E LENDES

I. ABSTRAKT	3
II. METODOLOGJIA	5
III. VESHTRIM I PERGJITHSHEM MBI ZONEN FUNKSIONALE DURRES	7
III.1. POZITA GJEOGRAFIKE & INFRASTRUKTURA	7
III.2. NDERTIMI GJEOLOGJIK DHE KLIMA	8
III.3. BURIMET MJEDISORE	9
III.4. PERBERJA E ZONES FUNKSIONALE, KUFIJTE DHE LIDHJA E NJESIVE ADMINISTRATIVE	9
III.5. HISTORIA, KULTURA, TRADITAT, ATRAKSIONET TURISTIKE	11
III.5.1. <i>Prezantimi i historise</i>	11
III.5.2. <i>Trashegimia kulturore, muzeale dhe etnografike</i>	12
III.6. TENDENCAT DEMOGRAFIKE	12
III.7. TIPARET Kryesore te ZONES FUNKSIONALE DURRES – QASJA E DLDP	14
III.7.1. <i>Koncepti i Zones Funksionale</i>	14
III.7.2. <i>Reforma Territoriale & Administrative & studimi i dldp mbi zonat funksionale</i>	14
III.7.3. <i>Gjetjet dhe propozimet e studimit te dldp per Zonen Funksionale Durres</i>	15
IV. EKONOMIA E BASHKISE SE RE DURRES.....	19
IV.1. PROFILI EKONOMIK I ZONES FUNKSIONALE	19
IV.1.1. <i>Prezantimi i pergjithshem i ekonomise se ZF Durres</i>	19
IV.1.2. <i>Numri, madhesia, perberja dhe lista e ndermarrjeve aktive ne ZF Durres</i>	20
IV.1.3. <i>Investimet ne ZF Durres</i>	32
IV.2. TREGU I PUNES, PUNESIMI, SHKALLA E PAPUNESISE.....	36
IV.2.1. <i>Arsimi, punesimi dhe nevojat e biznesit per kualifikime</i>	37
IV.2.2. <i>Konsultimi ne terren me 66 ndermarrje te Qarku Durres: te dhena mbi te punesuarit</i>	41
IV.3. NDERVEPRIMET EKONOMIKE DHE SEKTORET EKONOMIKE STRATEGJIKE.....	43
IV.3.1. <i>Levizjet e perditshme drejt qendrave te punes</i>	43
IV.3.2. <i>Industria Perpunuese</i>	45
IV.3.3. <i>Transporti & magazinimi</i>	46
IV.3.4. <i>Akomodime & sherbimi ushqimor</i>	47
IV.3.5. <i>Bujqesi (me Pyje, dhe Peshkim)</i>	49
V. PROFILI I SHERBIMEVE PUBLIKE LOKALE	57
V.1. FURNIZIMI ME UJE / KANALIZIMET	57
V.2. RRUGET & TRANSPORTI PUBLIK	63
V.3. MENAXHIMI I MBETJEVE NE ZF DURRES.....	67
V.3.1. <i>Ne nivel rajonal – Plani Rajonal i Menaxhimit te Mbetjeve (PRMM)</i>	68
V.3.2. <i>Ne nivel lokal – Plani Lokal i Menaxhimit te Mbetjeve (PLMM)</i>	72
V.3.3. <i>Vend-hedhja e Porto Romanos</i>	73
V.3.4. <i>Tarifat e mbledhjes - familjare</i>	74
V.3.5. <i>Pikat e dobeta te menaxhimi te mbetjeve</i>	75
V.4. PLANIFIKIMI URBAN DHE MENAXHIMI I TOKES NE ZF DURRES	77
VI. ORGANIZIMI I SHERBIMEVE TE PUSHTETIT VENDOR NE ZF DURRES	82
VI.1. PROFILI DHE SHERBIMET Kryesore te ofruara nga NJQV	84
VI.2. BUXHETET E NJQV TE ZF DURRES	86
VI.3. STRATEGJITE E ZHVILLIMIT DHE TE INTEGRIMIT 2014 – 2020 & PLANE E ZHVILLIMIT VENDOR	91
VI.3.1. <i>Perputhshmeria me strategjite sektoriale 2014-2020</i>	91
VI.3.2. <i>Lista e planeve strategjike te NJA-ve</i>	92

I. ABSTRAKT

Bashkia e Re e Durresit me teper se nje njesi vendore e Republikes se Shqiperise, eshte nje qender ku rrjetezohen dhe bashkohen nderveprime ekonomike dhe sociale per te gjithë vendin dhe per rajonin. Me 85% te ndermarrjeve aktive, totalitetin e qendrave manaxheriale te ndermarrjeve publike ne rang qarku (dhe disa ne rang republike si Porti i Durresit ose Hekurudhat Shqiptare), dhe 65% te popullates njesia administrative Durres (Bashkia aktuale) eshte qartesisht njesia dominante e Bashkise se re, e pakrahasueshme me forcen socio-ekonomike te pese njesive te tjera. Si pasoje NjA Durres do te mbizoteroje dhe percaktoje zhvillimin praktik te te gjithë Bashkise se Re.

Nga ana tyre te pese njesite e tjera (Manez, Sukth, Katund i Ri, Rrashbull dhe Ishem) jane te orientuara nga Durresi per vendin e punes (nder 11% dhe 72% e te punesuarve respektivisht te Ishmit dhe te Rashbullit punojne ne NjA Durres), sherbimet publike ne nivel Qarku, ato mjekesore dhe shkollore (kryesisht universitare). Fluksi i durrsakeve drejt ketyre pese njesive eshte i parendesishem statistikisht.

Persa i perket zhvillimit ekonomik Bashkia e Re Durres eshte pjese de-facto e Zones Metroplol Tirane – Durres. Si e tille ajo preket direkt nga zhvillime kombetare qofte ne investime publike, qofte ne terheqjen e investitoreve te huaj. Analize na jep te kuptojme se struktura ekonomike e Bashkise se Re Durres per te qene e qendrueshme, duhet te orientohet ne bistake ndermarrjesh por te ndihmuar me politika mbeshtetjeje strategjike nga shteti (shume me teper se nga Bashkia si psh: a) rreth perpunimit te tekstileve dhe lekure-kepuceve e ndihmuar me investime publike ne hulumtime, zhvillim produkti & procesesh dhe ne marketing, shpendarje dhe shitje; b) logjistike transporti me ndihme publike ne zhvillimin dhe modernizimin ne kontekstin ligjor te procedurave doganore dhe te infrastruktures se transportit; c) bujqesi me ndihme publike ne mbeshtetjen e fermerëve dhe internacionalizimin e produkteve shqiptare.

Ne rang vendi Bashkia e Re Durres eshte unike persa i perket koncentrimin te projekteve strategjike dhe investimeve perkatese ne infrastrukture. Nder me kryesoret mund te permendim Autostraden Blu qe pershkron Bashkine nga Veriu ne Jug; zhvillimin e Hekurudhave dhe lidhjen me Maqedonine dhe Kosoven; Zhvillimin e Portit te Durresit; zhvillimin e Zones Industriale te Spitalles prej 850 ha dhe me mundesi punesime deri ne 5,000 persona, etj. Sasia e investimeve dhe numri i vendeve te punes qe rezultojne nga keto zhvillime, eshte ndjeshem me i larte nga sa ka mundesi te cliroje Bashkia. Por po ashtu jane dhe eksternalitetet negative eventuale per banoret e zones. Ndikimi i autoriteteve Bashkiake ne percaktimin e profileve te ketyre investimeve dhe orientimi i tyre ne funksion te banoreve te Durresit, do te jene nje nga sfidat e Bashkise se Re.

Persa i perket sherbimeve publike te Bashkise se Re, vemendja jone terhiqet nga dy grupe kryesore: sherbimet publike administrative direkte ndaj qytetarit si psh sherbimet civile, dhe sherbimet publike ndaj kontekstit qe rrethon qytetarin, si psh menaxhimi i mbetjeve, uji dhe kanalizimet, etj. Ne rastin e pare gjate vitit 2015-2016 Bashkia e Re do te kete si sfide primare te pakten mbajtjen e cilesise dhe rrjetit te sherbimeve jo me keq nga situata para-RAT. Kjo do te kushtezohet nga mbulimi efektiv me sherbime ne te gjithë territorin. Sdq pervoja dhe ekspertiza e Bashkise aktuale Durres e plotesuar me eksperiencen dhe njohjen e terrenit te personelit te

pese njesive te tjera jane avantazhe qe duhet te perdoren me zgjuarsi per te prodhuar sukses. Sidoqofte, me konsolidimin dhe modernizimin e administrates se re bashkiake, pritet qe efienca e ketyre sherbimeve te rritet.

Ne rang republike, veme re qe sherbimet publike si menaxhimi i mbetjeve, uji dhe kanalizimet (e ndoshta dhe mirembajtja e rrugeve) po transferohen gradualisht ne ndermarrje te ndara nga administrata publike vendore (bile dhe qendrore). Rasti i mbetjeve eshte me tipiku. Ne kete prizem ngelet detyre e autoriteteve lokale te sigurojne mbajtjen e nje niveli te pranueshem sherbimi ndaj qytetareve me nje kosto demokratike.

Sidoqofte cdo zhvillimi domethenes i Bashkise se Re Durres do te kushtezohet nga implikimi, perkushtimi dhe investimet e qeverise qendrore. Implikimi real dhe kuptimplote i aktoreve lokale ne te gjitha fazat e identifikimit, planifikimit, kostimit, tenderimit, zbatimit, monitorimit te iniciativave dhe politikave publike do te jete kusht i nevojshem dhe i domosdoshem per nje njesi vendore te suksesshme. Per me teper kjo qasje nuk duhet te perfshije vetem NjA me te madhe, ate te Durresit, por te gjitha forcat aktive te shpendara ne Ishem, Rrashbull, Sukth, Katund te Ri dhe Manez. Cdo model i imponuar nga lart pa marre perqafimin e banoreve te Bashkise se Re Durres ne te gjitha njesite e saj administartive (qofte dhe ato me “ te parendesishmet” do te krijonte forca centrifuge mes njesive te territorit te Bashkise se re, dhe si pasoje do te ulte efikasitetin e punes se njesise vendore.

Si perfundim dhe pse Bashkia e Re Durres per momentin ngjan me buall i vene ne parmende me pese langonj, kjo njesi e re per nga vete pozita gjeografike, struktura industriale, profili njerezor dhe historia mijejcare ofron mundesi praktike per nje skenar suksemi jo vetem ne nivel kombetar por dhe ne ate nderkombetar. Pese njesite e reja, nqs behen pjese aktive e planifikimit dhe zhvillimeve strategjike te njesise se re, do ti ofrojne Durresit hapesiren gjeografike, biznese dhe mundesine njerezore per te qene Bashkia model e Republikes se Shqiperise ne shekullin e XXI.

Kohezioni mes gjashte njesive vendore dhe perkushtimi i njesive ekonomike dhe i banoreve te saj, ka potencialin ta beje Bashkine e Re Durres aktor kombetar qe se bashku me Tiranen te drejtojne zhvillimin e territorit ne vend ne vitet e ardheshme.

II. METODOLOGJIA

Mbledhja e informacionit u bazua ne perberesit e meposhtem:

- *desk research*. Kryesisht studimet zhvillimore per secilen nga gjashte NjQV e plotesuar me te dhena statistikore (nga INSTAT per te dhenat mbi demografine; Ministria e Financave per njesite ekonomike; QKR per numrin e biznesve aktive; Botimet e Bashkise Durres dhe te Qarkut per te dhenat mbi Qarkun e Durresit; Sherbimi Kombetar i Punesimit per punesimin; ShtetiWeb per dokumentet e politikave sektoriale 2014-2020, etj).
- takime me perfaqesues te te gjithave njesive vendore (te pakten tre here ne secilen njesi). Keto takime heren e pare paten karakter prezantues te projektit dldp dhe te CDI, dhe duke filluar nga hera e dyte u bazuan ne nje axhende paraprake dhe liste prezence. Axhenda u fokusua ne: a) situaten aktuale te NjQV; b) mbledhjen e informacioneve kryesisht nga drejtoria e Tatim Taksave, nga Drejtoria e Zhvillimit dhe nga Drejtoria e Ekonomise / Financave; c) projektet ne zhvillim dhe ato ne pergatitje me ndikim nder-NjQV;
- vrojtim ilustrues ne 62 njesi ekonomike te Qarkut te Durresit. Qellimi ishte identifikimi i tendencave te renda mbi natyren e kualifikimeve qe NjE ne Durres planifikojne te kene nevoje ne te ardhmen;
- takime me perfaqesues te paleve te interesuara ne zhvillimin e FA Durres (Fondi Shqiptar i Rajoneve, Agjencia e Zhvillimit Rajonal, Dhoma e Tregtise e Durresit, Universiteti Aleksander Moisiu, OJQ aktive ne planet e zhvillimit rajonal te Durresit, etj).

Trajtimi i informacionit rezultoi ne rregullarizimin dhe homogjenizimin e informacioneve, klasifikimin, organizimin dhe nderlidhjen logjike funksionale te tyre. Hapi tjetër ishte pergatitja e struktures se analizes dhe e prezantimit te rezultateve.

Probleme metodologjike rrjedhin nga:

- Prodhimi i te dhenave te INSTAT vetem ne rang Qarku (ne rang komune Bashki eshte perjashtim extra i rralle);
- Mos-paraqitja sistematike e c' regjistrimit te NjE ne QKR, edhe pse ne zyrat e tatimeve rezultojne si jo-aktive;
- Paraqitja ne regjistrin e taksave vendore te subjekteve qe kane ne pronesi toke bujqesore dhe / ose sipërfaqe urbane dhe mos-regjistrimi i tyre ne QKR dhe rrjedhimisht ne regjistrin e taksapaguesve ne tatimet qendrore.

Si pasoje shifrat e paraqitura jane nje perafersim ilustrativ qe shprehin trendet e zhvillimit.

Faza e analizes ekonomike ka ndjekur hapat e meposhtem:

- Pergatitja e planit te punes. Perfshin identifikimin e aktoreve me te rendesishem lokal dhe kombetare, te sektoreve te aktivitetit, te problematikes se amalgamimit ne varesi te ligjit 115/2014 dhe te stadit te avancimit te ligjit mbi decentralizimin, si dhe logjistikën perkatese.

- Identifikimi i burimeve te informacionit. Te dhenat jane ndertuar nga autoret bazuar ne te dhenat e marra nga INSTAT, te dhenat e tatim - taksat nga vete NjQV e zones funksionale, nga publikimet dhe te dhenat nga Ministria e Financave, nga QKR, nga Sherbimi Kombetar i Punesimit, nga intervista me 62 Njesi ekonomike bazuar ne nje pyetesor, si dhe nga biseda individual me pergjegjes te sektoreve te finances, zhvillimit ekonomik, tatim-taksave, drejtues komune dhe bashkie, pergjegjes urbanizmi, etj. Duke nenvizuar differencat mes ketyre burimeve te informacionit, llogaritjet tona jane bazuar ne tendecat e renda dhe rrafshin krahasimor, me teper se sa ne saktesimin sasior dhe te dhenat absolute.
- Per mundesi krahasimi, neve jemi perpjekur te perdorim nomeklaturen e klasifikimeve te aktiviteteve ekonomike per te klasifikimin e te dhenave ne baze sektori aktiviteti (bazuar ne NVE REV 2, INSTAT 2014).
- Perfshirja e te interesuarve. Ne kete faze jemi fokusuar tek aktoret qe kane infomacionin dhe interesin direkt ne analizen e zones funksionale. Ketu jane perfshire kryetaret e komunave dhe bashkive, zyrtare te FShZh, anetare te Dhomes se Tregetise dhe Industrise Durres, biznesmene vendore, drejtues shkollash, akademike nga Universiteti Aleksander Moisiu, etj. Ne kete faze kemi vene re qe bashkia e Durresit eshte e mbi-perfaqesuar me aktore te shoqerise civile krahasuar me te pesta njesite vendore qe i bashkalidhen. Si pasoje, kemi adaptuar dhe qasjen ndaj forumit duke e shtyre ne kohe, si dhe duke i adaptuar objektivat.

Kendi i analizes eshte ndertuar ne funksion te mire-funksionimit dhete eficience se ZF Durres. Si pasoje neve jemi fokusuar ne modalitetet e nder-veprimit te njesive mes tyre, me shume se ne planet e zhvillimit strategjik te se teres.

Referencat bibliografike

1. *The Functional area approach in the dldp 3 framework. Tirane, June 20th 2014*
2. *The issue of functional areas in the National Spatial Development Concept 2030 and Assumptions Partnership Agreement, Magdalena Zagrzejewska*
3. *Methodological note on the Functional Area Programme*


III. VESHTRIM I PERGJITHSHEM MBI ZONEN FUNKSIONALE DURRES

III.1. Pozita gjeografike & Infrastruktura

Qendra e Zonës Funktionale ZF Durrës (ZF Durrës) është Bashkia Durrës me qytetin e Durrësit. Ajo përmban Bashkinë e Manzes me qendër në Manez, Bashkinë Sukth me qendër në Sukth, Komunën Ishëm në ekstremitetin verior të saj me qendër në Likmetaj, Komunën Rrashbull në ekstremin jugor me qendër në Rrashbull, dhe Komunën Katund i Ri me qendër në Katundin e Ri. Bashkia ndodhet ndërmjet 41° e 36' deri 41° e 15' gjerësi gjeografike veriore dhe 19° e 15' deri 19° e 38' gjerësi gjeografike lindore. Ai shtrihet nga kepi i Rodonit në veriperëndim deri tek Prroi i Agait pas shkëmbit të Kavajës në jugperëndim. Ka një sipërfaqe prej 430 km² një lartësi mesatare mbi nivelin e detit 2-6 metra. Vetëm qyteti i Durrësit zë pjesën perëndimore të rrethit të Durrësit midis koordinatave 41° e 18' e 40'' gjerësi gjeografike veriore deri në 19° e 26' e 21'' gjatësi gjeografike lindore me sipërfaqe 1,626 ha. Gjatesia e përgjithshme e vijës kufitare është 121.3 km. Nga këta 52.4 janë kufij tokësorë, 61.8 kufij detarë, 7.1 janë kufij lumorë.

Në pjesën perëndimore Durrësi laget nga deti Adriatik, duke pasur një vijë bregdetare të thyer. Kufijte tokësorë janë me rrethin e Tiranës dhe Krujës në lindje dhe verilindje dhe me rrethin e Kavajës në jug dhe juglindje. Të gjitha njesitë, përveç Manzes kanë dalje në det. Vetëm KiR dhe Rrashulli kanë kontakt gjeografik direkt me Bashkinë e Durrësit.

Harta 1. Zona Funktionale Durrës



burimi. Instatgis

Bashkia e Re e Durresit (*ne studim termi Bashkia e Re e Durresit dhe Zona Funkzionale Durres percaktojne te njejin territor*) ka pozite te favorshme gjeografike dhe ndodhet ne kryqezimin e rrugëve te medha tregtare. Nder rruget kryesore jane: Durres-Oher-Manastir-Sofje-Stamboll; Durres-Elbasan-Korce-Follorine-Selanik. Durresi ka rendesi e madhe strategjike. Durrësi është i vendosur në brigjet e detit Adriatik rreth 33 km, në perëndim të kryeqytetit Tiranë. Ai ndodhet në një nga pikat më të ngushta te Detit Adriatik përballë porteve italiane te Barit (300 km larg) dhe Brindisit. Sot, qyteti përhapet jashtë në vendbanimet e ndërtimeve në fushën nga lindja. Vendi është mjaft i ulët në jug në gjirin e Durrësit. Distancat jane 39 km larg nga Tirana; 30 km larg nga Aeroporti nderkombetar “Nënë Tereza”; 150 km larg nga pika kufitare me Malin e Zi (Hani i Hotit); 243 km larg nga pika kufitare me Kosoven (Morinë); 162 km larg nga pika kufitare me Maqedonine (Qafë Thanë) dhe 184 km nga Tushemishti, si dhe 178 km larg nga Bllata.

Durrësi është qendra e sistemit hekurudhor shqiptar. Gjithashtu Durrësi është edhe porti më i rëndësishëm në vend dhe lidhet me Italinë me anë të trageteve të linjës Durrës - Bari, Durrës - Ankona, Durrës - Trieste. Lidhet me Slloveninë me anë të tragetit të linjës Durrës - Kuper. Për më tepër Durrësi është edhe pikënisja e korridorit 8, si dhe kryqëzim i linjave më të rëndësishme të rrugëve, ku më e rëndësishmja është linja Durrës - Kukës - Morinë e cila lidh Shqipërinë me Kosovën.

Porti i Durrësit ka një sipërfaqe të përgjithshme prej 1,4 km² dhe një akuatorium prej 0,67 km². Kanali i hyrjes është 9,5 m i thellë, 40 m i gjerë dhe 1,2 milje i gjatë. Në port funksionojnë 11 kalata operues nga 6,6-11 m të thella më një gjatësi rreth 2.200 m. Sipërfaqja totale për depozitimin e mallrave është 270.000 m² nga të cilat 27.000 m² janë të mbuluara.

Në portin e Durrësit ngarkohen dhe shkarkohen të gjitha llojet e mallrave mineralë, karburante, cemento dhe artikuj të kategorive të ndryshme. Aktualisht, në portin e Durrësit është dyfishuar numri i trageteve krahasuar më një vit më parë. Çdo javë në këtë port akostohen rreth 40 tragete dhe katamarane që lidhin Durrësin më portet e tjera të Mesdheut.

Terminali i konteniereve është në fazën ndërtimore. Përveç kalates dhe sheshit që ka në dispozicion, në ndihmë të terminalit të konteniereve në portin e Durrësit ndodhen edhe një sërë pajisjesh që ndihmojnë në ngarkim-shkarkimin e tyre.

Porti i Porto-Romanos shërben për ankorimin dhe shkarkimin e anijeve cisterne që sjellin hidrokarbure dhe gaz në terminalin e Portit. Në bashku me Petroliferen, Porto Romano është porti më i madh për hidrokarburet në Shqipëri nga ku shpërndahen shumica e produkteve të importuara që konsumohen në vend.

III.2. Ndertimi gjeologjik dhe klima

Durresi është pjesë e ultësirës praneadriatike, që shtrihet nga Lezha deri në Vlorë. Zhvillimi gjeologjik i territorit të Durresit i përket Pliocenit dhe Kuaternarit kur ultësira praneadriatike nisi të dalë mbi ujë si pjesë e kontinentit. Deti u terhoq perfundimisht. Gjatë kësaj periudhe në Kuaternar kanë ndodhur shumë procese që kanë çuar në formimin e strukturave antiklinale dhe sinklinale. Territori i Durresit përbehet gjithashtu nga depozitime terrigjene (ranore, konglomerate, argjile, gelqeroresh etj.). Në territorin e Durresit ka dhe prurje aluvionale. Në ndertimin e relievit të Durresit kanë ndikuar edhe termetet. Pasoje e këtij ndertimi gjeologjik janë edhe pasuritë në tokësore si qymyrguri (kryesisht në Bashkinë e Manzes) etj.

Durresi ka një klimë mesdhetare. Temperatura është e ulët – rreth 5 ° C në janar dhe e lartë – rreth 28 ° C në Korrik dhe Gusht. Qershori, Korriku dhe Gushti janë muajt, më të nxehtë dhe

më të thatë. Ne formimin e klimes ndikojne nje sere faktoresh sic jane faktoret planetare (kozmiqe) dhe ato lokale. Faktoret lokale jane te lidhur me relievin. Faktori me aktiv ne klimen e Durresit eshte ndikimi i detit nepermjet te cilit behet i mundur qarkullimi i masave ajrore te Atlantikut dhe te Mesdheut. Ne faktoret lokale ben pjese edhe veprimtaria e njeriut, qe ne Durres eshte shprehur me nderhyrjet ne kushtet natyrore. Ketu mund te vecojme tharjen e kenetes, c'pyllezimin ne zonat kodrinore, etj, ndertimi i ujembledhezve apo ngritja e objekteve industriale, etj.

Ererat jane nje element me rendesi te madhe gjeografike dhe agrometeorologjike per ultesiren perendimore. Ererat karakteristike per Durresin jane brizat. Gjate veres ne Durres ka rreth 71 dite me briza, kurse ne dimer 18 dite. Numri mesatar vjetor eshte 191 dite. Ne perputhje me motin briza fillon nga ora 9-10 paradite dhe vazhdon deri ne 16-18 pas dite. Shpejtesia mesatare e saj ne mesdite eshte 4-6 m/s. Ererat qe ndihet ne Durres jane Murrai, Shiroku dhe Juga. Element tjetër i klimes eshte vranesira. Numri mesatar i diteve te vraneta eshte 89.9 dite/vit ndersa dite te kthjellta eshte 110.6 dite ne vit.

III.3. Burimet mjedisore

Ajri. Nisur nga monitorimet e gjashtë-mujorit të parë të vitit 2012 (rreth 7,500 monitorime) cilësia e ajrit në këtë periudhë në Bashkinë Durrës është problematike, si pasojë e rritjes së grimcave PM.2.5 dhe PM10. Faktoret që kontribuojnë janë: rritja së vëllimit të ndërtimeve, ngritja e pluhurit, lëvizja e automjeteve, në vende të caktuara, cilësia jo e mirë e rrugëve, shtimi i numrit të industrive, cilësia e keqe e karburanteve apo edhe nga djegia e mbeturinave në kontenerët në qytet, por edhe nga djegia e tyre në zonën e vendgrumbullimit të mbetjeve. Të gjithë këta faktorë përbëjnë një kërcënim serioz për të ardhmen e cilësisë së ajrit në Durrës.

Uji. Zona e Durrësit është e pasur me ujëra të cekta nëntokësore. Për këtë arsye ato janë edhe lehtësisht të kërcënuara nga ndotja. Duke pasur parasysh të shkuarën e Durrësit si një zonë industriale në periudhën e qeverisë komuniste, kjo ndotje është edhe më shqetësuese. Ujërat e cekta nëntokësore në zonën e Durrësit vijnë nga basenet e Ishmit dhe Erzenit. Këto ujëra kanë një përmbajtje të pH prej 7 deri 9 dhe janë të pijshëm. Akuiferi i ujërave të Tiranës është shumë i fortë me rreth 18 -300 dH; niveli mesatar shkon 10 – 200 dH maksimali është 250 dH. Plotësimi i nevojave në rritje të Durrësit mendohet se do të bëhet përmes prurjeve të reja nga Bovilla e Tiranës. Kjo do të thotë që prurjet në Durrës do të dyfishohen nga 350 l/s në rreth 700 l/s.

Toka. Toka në Durrës siç e përmendëm edhe më sipër ka karakteristika të ndryshme. Kemi tokë bujqësore, pyje dhe kullota si ne Manze dhe Ishem, tokë ranore në bregun e detit si dhe tokën e zonave industriale dhe ish industriale.

Sizmiteti. Durrësi konsiderohet si qendra e tërmeteve në Shqipëri. Përshpejtimi varion nga 0.2g në të gjitha territorin në 0.3-0.38g në pjesën jug dhe veri perëndimore të vendit.

III.4. Perberja e Zones funksionale, kufijte dhe lidhja e njesive administrative

Ne perputhje me Ligjin nr. 115/2014 "Për ndarjen administrativeo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë" 31.07.2014 i cili percakon si njesi te qeverisjes vendore (NJQV): 61 bashki dhe 12 qarqe, ZF Durrësit eshte pjese e Qarkut te Durresit dhe perbehet nga 6 njesi administrative (NJA): Durrës, Sukth, Ishëm, Katund i ri, Rrashbull dhe Manëz. Ne perberje te tyre keto NJA perfshijne gjithsej 3 qytete dhe 40 fshatra (si dhe gjashte rajone dhe 14 lagje per Durresin).

Zona Funktionale Durres (ZFD), perbehet si me poshte (dhe do te referohet si e tille ne pjesen e mbetur te dokumentit):

- NjA Durres: Qyteti Durrës
- NjA Sukth: Qyteti Sukth, Hamallaj, Kullë, Perlat, Vadardhë, Rushkull, Hidrovori;
- NjA Ishem: Likmetaj, Kërtushaj, Kapidanaj, Gjuricaj, Lalëz, Kuraten, Bizë, Draç, Shetaj;
- NjA Katund i Ri: Katundi i Ri, Jubë, Qerret, Fllakë, Bisht-Kamëz, Rinia, Erzen, Sukth, Adriatik;
- NjA Rrashbull: Rrashbull, Arapaj, Shënavlash, Shkallnur, Manskuri, Romanat, Bozanhije, Xhafzotaj;
- NjA Manëz: Qyteti Manëz, Armath, Borç, Hamallaj, Kameron, Radë, Shkallë, Fshat Manëz.

Bashkia Durres eshte e ndare ne gjashte rajone te cilet perfshijne 14 lagje. Me poshte vijon nje pasqyre e ndarjes administrative e Bashkise se Durresit (*Bashkia Durres perkon me Njesin Administrative Durres ne Bashkine e Re Durres*):

Tabela 1: Ndarja administrative e Bashkise se Durresit

Emërtimi	Rajoni Nr 1	Rajoni Nr 2	Rajoni Nr 3	Rajoni Nr 4	Rajoni Nr 5	Rajoni Nr 6
Sipërfaqja km ²	2.98	1	0.6	10.32	15.8	15.4
Popullsia	28,667	28,737	27,718	53,890	34,999	34,015

Lagjet që përfshihen në çdo Njësi Administrative apo Rajon janë:

- Rajoni 1: lagjet 1, 2, 3, 4
- Rajoni 2: lagjet 6, 7, 9, 10, 11
- Rajoni 3: lagjet 5, 12, 16
- Rajoni 4: lagjet 8, 15, 18
- Rajoni 5: lagjet 17, 13, 14
- Rajoni 6: lagjet pjesë nga Rajoni 5, 4, 3 (e krijuar rishtas)

Ndër rajonet që kanë zona informale me sipërfaqe dhe popullsi të konsiderueshme janë rajoni 4, 5 dhe 6.

Të gjitha NjA-te janë në distancë të pak a shume favorshme nga qendra e ZF, qytetit i Durresit. Njësia me distancë më të largët nga Durrësi është Ishëm me 37 km. Distanca e NjA-ve të tjera nga qytetit i Durresit eshte e papërfillshme. Infrastruktura që lidh Sukthin dhe Rrashbullin me qytetin e Durresit është e re, e ndërtuar në 10 vitet e fundit dhe secila nga këto njësi ka akses në qendër në me pak se 30 minuta.

Lidhja e të gjitha NjA-ve të reja ndryshon kryesisht në varesi të distancës nga Durresi dhe të historisë së shkëmbimeve tregtare dhe njerezore. Njësia me "te largeta" janë Ishmi dhe Manza. Në përgjithësi të gjitha njësia lidhen me qytetin e Durresit nëpërmjet shkëmbimeve me natyrë vendimtare si punësimi, edukimi dhe shëndetësia, dhe ndajnë të njëjtin territor të vazhduar. Gjithashtu me rëndësi janë dhe shërbimet publike si psh menaxhimi i mbetjeve, kanalizimet dhe uji i pijshëm. Pese prej tyre (Durrës, Sukth, Ishëm, Katund i ri, Rrashbull) shtrihen direkt në bregdet dhe menaxhojnë një pjesë të bregut duke ndarë interesa të përbashkëta në zhvillime infrastrukturore, urbane, mjedisore dhe industriale orientuar kryesisht drejt turizmit, tregtisë, industrisë fashone dhe asaj përpunuese.

Bashkia e Duresit, si e dyta me e madhe ne vend (pas asaj te Tiranës) ka dhe zona me profil te vecante si me poshte:

- a) *Zona e Porto Romanos* përfaqëson një nga faqet më komplekse të përdorimit të tokës së Bashkise se Durrësit. Kjo zonë është përdorur më parë për veprimtari kimike, që e kanë lënë atë si një zonë me rrezik të lartë. Zona ka edhe disa gjurmë të rëndësishme arkeologjike (një mur të lashtë për mbrojtjen e tij). Sot kjo zonë do të marrë projektin e një parku industrial. Një shtrirje vendbanimesh me densitet të ulët, kryesisht informale është zhvilluar edhe në këtë fushë në drejtim të jugut. Këto vendbanime janë të identifikuar si zona me përparësi të rihvillimit urban nga ALUIZNI përgjegjëse për legalizimin e vendbanimeve informale.
- b) *Rrashbulli* - Kjo është ende një zone informale brenda kufirit të përbashkët të Durrësit në perëndim, e cila gjithashtu ka një plan për legalizim nga ALUIZNI.
- c) *Zona e autostrades* - Zona edhe pse ndodhet jashtë qytetit dhe ne fushën e shkëmbimit të nivelit të autostradave të ndryshme, bie brenda kufirit të tij administrativ. Nga pika e parë e vendndodhjes, kjo zonë ka një vlerë shume strategjike në lidhje me zhvillimin e aksit metropolitan mes Durrësit dhe Tiranës.

III.5. Historia, kultura, traditat, atraksionet turistike

Bashkia e Re e Duresit eshte nje nga zonat gjeografike me te pasura ne kendveshtrimin historik dhe kulturor. Si porta e hyrjes ne Shqiperi, qyteti i Duresit ofron eksperiencen dhe pershtypjen e pare te turisteve qe vijne ne Shqiperi nga deti.

III.5.1. Prezantimi i historise

Durresi mund te krahasohet me qytetet me te medhenj te Mesdheut antik dhe mesjetar. Qyteti Epidamn - Dyrrah u ndertua nga Iliret Taulante, dallendyshasit ne shekujt XIII-XI p K. Ne kushtet e nje klime mesdhetare, zona me e pershtatshme per banim ishte ajo rreth lumit Erzen si dhe Ultesira Perendimore perreth saj. Ne bregdetin e Gjirit te Duresit u vendos qendra e pare apo Limani me emrin Dyrrah. Sipas autoreve antike, ky qytet u themelua nga dy mbreter me origjine ilire te quajtur Dyrrah dhe Epidamn. Ne kohen e Perandorit Anastas i I (491-519) dhe Justianani I (527-565), qyteti pesoi transformime te ndjeshme ne strukturen urbane duke marre tiparet e nje qyteti tipik bizantino-kristian.

Ne shek. XI-XV, trevat Shqiptare njiheshin me emrin Shteti i Arbrit. Ky shtet, kulmin e tij e arriti ne periudhen e mbreterimit te Gjergj Kastriotit. Sipas kronikaneve Osmane te shek. XVI, Durresi apo sic e cilesojne ata "Kostandinopoja e Dyte", u pushtua nga turqit me 13 Gusht 1501 dhe u shkaterrua. Vetem ne shek XVII, qyteti filloi te rimarre veten duke bere qender e tregtise tranzite dhe skela kryesore e Shqiperise se Mesme. Ne date 26 Nentor ne Durres ngrihet flamuri i Pavaresise, nga nje grup patriotesh te kryesuar nga atdhetari Ismail Qemali. Pas perandorise Otomane qyteti perjetoj pushtimin serb (1913), austro-hungarez (1916) dhe italian (1918).

Gjate viteve te monarkise shqiptare (1924-1939) Durresi fitoi nje frymarrje te re dhe qytetaria fisnike durrsake e beri qytetin e vet model te zhvillimit ekonomik kapitalist. Me 7 Prill 1939 qyteti dhe rrethinat e tij u pushtuan nga trupat e ushtrise italiane dhe gjermane dhe me 14 Nentor 1944, Durresi u clirua nga Ushtria Nacionalclirimtare Shqiptare. Periudhes se sistemit socialist (1945-1990), i perkasin investimet ne disa dege te industrise, kolektivizimi i bujqesise, masivizimi i arsimit, ngritja e nje seri objektesh social-kultuore. Ne fillim te viteve '90 erdhi sistemi demokratik me shume probleme per fazen e tranzicionit, por me perspektive per te ardhmen. Sistemi i ri dhe reformat ekonomike qe u zbatuan ne Shqiperi dhe ne Durres pas vitit

1990, sollen transformime te ndjeshme ne jeten ekonomike, sociale dhe ne te gjithë strukturen urbanistike te zones.

III.5.2. Trashegimia kulturore, muzeale dhe etnografike

Durresi eshte nje qytet me kulture te hershme, per vete origjinen e tij te lashte. Qyteti ka trasheguar mjaft vlere te se kaluares, qendra historike dhe arkeologjike si Amfiteatri, Rrethoja Bizantine, Torra Veneciane, Muri rrethues i Kalase, Vila Mbretore, Kulla e Vrojtimit por edhe qendra kulturore e fetare si rrenojat e Bazilikes ne Arapaj, keshtjella e Rodonit etj.

Ne Durres gjenden nje rradhe muzesh dhe monumentesh si: Muzeu Arkeologjik, Muzeu Etnografik, Monumneti i Mujo Ulqinakut, Monumenti i John Lenon, Monumenti i Sabri Tucit, Mozaiku i Orfeut etj. Qyteti ruan sot plot gjurme edhe nga kultura me e vone, duke kontribuar edhe ne dhenien e personaliteteve me vlere nderkombetare si Aleksander Moisiu, qe u lind ne Kavaje dhe u rrit e u formua ne Durres. Qyteti ka institucione kulturore te konsoliduara, si Teatri Aleksandër Moisiu, Teatri i estrates, ansambel kengesh e vallesh popullore i cili edhe sot jep shfaqje per publikun, trupe muzikore profesionistesh etj. Gjithashtu ne Durres organizohen aktivite ne rang kombetar e nderkombetar si festival nderkombetar i filmit (Durres International Film Festival), Festivali muzikor i jazz-it, Konkursi i poezise Poeteka, Festivali Nderkombetar i Dansit Modern, Maratona e Kenges Popullore dhe Qytetare, Festa e Ullirit, Festivali Nderkombetar i Muzikes se Dhomes, Panairi Veror i Librit etj.

Etnografia e Durresit, i perket kultures se Shqiperise se Mesme, ku grate vishen me dimi e me jeleke, ne koke mbajne nje feste te vogel zburuar me imitime monedhash, kurse burrat veshin brekushe, xhoka te zeza prej leshi ose jeleke te kuq,dhe ne koke mbajne qeleshe me male te sheshte. Gjithashtu edhe kenget e vallet i perkasin kultures dhe traditave te Shqiperise se Mesme.

III.6. Tendencat demografike

Sipas Census-it të popullsisë dhe banesave të vitit 2011 popullsia totale e qarkut Durres eshte 262,785 banorë, nga të cilët rreth 203,000 i perkasin rrethit të Durrësit dhe 59,814 rrethit të Krujës. Sipas ketyre te dhenave ky qark renditet i katërti në Shqipëri për nga numri i popullsisë dhe ashtu si Tirana është një nga destinacionet kryesore për migrimin e brendshëm.

Por te dhenat e Censurit 2011 jane shume më të ulëta se ato të Regjistrit të Gjendjes Civile (RGJC). Sipas tij në janar 2012 popullsia e qarkut të Durrësit rezulton 414,677 (në rrethin e Durrësit 336,524 banorë dhe në rrethin e Krujës 78,153 banorë). Diferenca e madhe midis popullsisë rezidente dhe asaj në RGJC vjen si rrjedhim i emigracionit të lartë që vjen kryesisht nga qyteti i Durrësit dhe zonat perreth. Ky faktor pasqyrohet ne frekuencen shume te larte te perfaqesimit te ndermarrjeve te perbashketa shqiptare - te huaja te vendosura kryesisht ne qytetin e Durresit (sic do ta shohim me vone).

Census-i i popullsisë të vitit 2011 evidenton një rritje popullore prej 9% në këtë qark, kryesisht në zonat urbane. Popullsia në zonat urbane të qarkut (bashkitë) u rrit me 56% gjatë kësaj periudhe. Prurjet më të mëdha besohet të kenë ardhur nga zonat rurale të vetë qarkut të cilat janë tkurrur me 46%, si dhe nga zonat verilindore kryesisht te arritur ne zonen e Kenetes, Bashkia Durres.

Me konkretisht, duke iu referur Censurit të vitit 2011 popullsia e pergjithshme e ZF është 175,110 banorë. Perberja gjinore eshte pothuajse e barabarte 87,613 meshkuj dhe 87,497 femra. Popullsia aktive ne intervalin 15-64 vjec perben rreth 68.22 % te numrit te pergjithshem te banoreve.

Aktualisht ne Drejtorine Rajonale et Punesimit ne Durres (DRPD) jane te regjistruar ne total 8,956 punekerkues te papune (PP), nga te cile 4,640 jane femra. Per arsye se ne qarkun e Durresit qendra tjeter e punesimit eshte ne Kruje (1,100 PP nga te cilet 596 jane femra), te dhenat e DRPD nuk mund te shperbehen ne rang njesie administrative te ZF Durres. Ne rang Qarku, te rinjte deri ne 25 vjec, perbejne 29,5% te PP, ndersa 42,6% jane PP me arsim te mesem. Punesimi dhe trajnimi profesional do te trajtohet ne piken IV.2 te analizës.

Tabela 2 : Popullsia në ZF Durrës

NJA	Numri i banoreve											
	Gjithsej				Meshkuj				Femra			
	Gjithsej	0-14	15-64	65+	Gjithsej	0-14	15-64	65+	Gjithsej	0-14	15-64	65+
Durrës	113,249	21,799	78,528	12,922	56,511	11,467	38,817	6,227	56,738	10,332	39,711	6,695
Sukth	15,966	4,058	10,502	1,379	7,999	2,136	5,178	685	7,967	1,949	5,324	694
Ishëm	5,001	1,174	3,229	598	2,487	596	1,598	293	2,514	578	1,631	305
Katund i ri	10,161	2,453	6,715	993	5,071	1,273	3,332	466	5,090	1,180	3,383	527
Rrashbull	24,081	5,700	16,092	2,289	12,194	3,022	8,045	1,127	11,887	2,678	8,047	1,162
Manëz	6,652	1,502	4,400	750	3,351	778	2,204	369	3,301	724	2,196	381
Gjithsej	175,110	36,686	119,466	18,931	87,613	19,272	59,174	9,167	87,497	17,441	60,292	9,764

Burimi: INSTAT, Census 2011, Llogaritja e autoreve

Bashkia e Durresit eshte nje prej bashkive me te medha te vendit me siperfaqe prej rreth 298.3 km² dhe nje popullsi prej rreth 219,867 banore, me nje dendesi nga me te lartat ne vend prej 737.3 banore/km². Struktura e popullsisë e kesaj njesie vendore is 85% urban and 15 rural.

ZF Durres eshte nje zone me nje dendesi shume te larte popullsisë 681 banorë/km². Ajo eshte dy here me e larte krahasuar me dendesine ne nivel kombetare prej 343 banore/km². Edhe pse NjA Durrës ze vetem rreth 11.24 % te siperfaqes totale te ZF ajo perfaqeson rreth 64.67 % te popullsisë se ZF duke patur nje dendesi dukshem te larte. Ndërsa NjA Ishëm mbulon rreth 26.9 % te territorit, por ka nje dendesi prej vetem 55 banorë/km².

Tabela 3: Dendësia e popullsisë dhe distanca e NJA-ve në ZF Durrës

NJA	Popullsia	Sip. Km ²	Dendesia banore/km ²	Distanca nga qendra e ZF
Durrës	113,249	38.00	2,980.00	0.00
Sukth	15,966	53.00	301.00	14.00
Ishëm	5,001	91.00	55.00	37.00
Katund i ri	10,161	54.00	188.00	19.00
Rrashbull	24,081	59.00	408.00	10.00
Manëz	6,652	43.25	154.00	15.00
Gjithsej	175,110	338.25	681.00	

Burimi: INSTAT, Census 201, Llogaritjet e autorëve

Distanca mesatare e pese NJA-ve nga qyteti i Durrësit (qendra e ZF Durrës) është 19 km, por vihet re që NJA Ishëm, e cila ka një dendësi të ulet të banorëve ka njëkohësisht dhe largësinë të madhe prej 37 km nga qendra e ZF dhe njëkohësisht shërbimet e ofruara atje.

ZF Durrës është me karakter dukshëm monocentrik. Këtu vihet re ekzistenca e një qendre të madhe rajonale me një prurje të fortë të banorëve të rinj. Qyteti i Durrësit së bashku me rrethinat është shumë i rëndësishëm për të gjithë zonen si qendër ekonomike. Por, ndërkohë që qendra rajonale është shumë e fuqishme, ka gjithashtu nën-qendra më të vogla të cilat shërbejnë si një qendër lokale për zonat e tyre rurale përreth. Në një mënyrë në ZFD gjejmë zona me dy tipe qendra të specializuara: kryeqytetin e madh të rajonit që ofron kryeqendren ekonomike & sociale dhe qytetet/zat administrative të shpendara në zonë ku njerëzit marrin disa nga shërbimet komunale dhe përdorin tregjet lokale. Po ashtu në ZF Durrës identifikohen tendenca relativisht të verejtshme shkëmbimesh mes banorëve të NJA të Katundit të Ri, Rrëshbullit e Sukthit.

III.7. Tiparet kryesore të Zonës Funktionale Durrës - qasja e dldp

III.7.1. Koncepti i Zonës Funktionale

Termi 'zona funksionale' i referohet nocionit të hapësirës - në cilindo nivel të jetë (bashki, qarqe dhe kështu me radhë) - nuk duhet përcaktuar sipas vijave administrative apo atyre historike, por duhet bazuar në bazë të ndër-veprimeve që ndodhin në atë hapësirë. Kjo për të treguar, për shembull, mënyrën si përdoret nga banorët e saj ose në bazë të bashkëpunimit që ndodh ndërmjet enteve të ndryshme qeveritare ose ekonomike.

Koncepti i zonës funksionale, në kontekstin e studimit të kryer nga DLDP, përdoret për të përkufizuar një hapësirë ku ka një ndërveprim të dendur dhe të shpeshtë mes banorëve dhe institucioneve për qëllime ekonomike, sociale, zhvillimore dhe kulturore. Zona funksionale është e organizuar rreth një qendre urbane që ka numrin më të lartë të popullsisë, krahasuar me qendrat e tjera brenda zonës dhe ka mundësi për ofrimin e gamës së plotë të shërbimeve publike që duhet të ofrojë një njësi vendore.

Në themel të konceptit të zonës funksionale vendoset qytetari dhe nevojat e tij për shkëmbime të vazhdueshme në territor, të cilat i tejkalojnë kufijtë aktualë administrativë. Ndërveprimet e qytetarëve janë me administratën shtetërore, qendrat e biznesit dhe të punësimit, qendrat e ofrimit të shërbimeve, arsimit dhe shëndetësisë, dhe artit e kulturës. Kriteret e përcaktuara janë përdorur për të kryer analizën e shkëmbimeve duke nxjerrë në pah polet kryesore që mbështesin zhvillimin në secilën zonë. Zonat funksionale ndërtohen mbi strukturën ekonomike dhe sociale të territorit dhe identifikohen kryesisht nëpërmjet lëvizjeve për punësim, potencialit ekonomik dhe zinxhirit të vlerës (përqendrimi i bizneseve); ofertës së shërbimeve dhe rrjetit të infrastrukturës fizike. Qendrat e zonave funksionale kanë popullsi dhe dendësi më të madhe, janë destinacione të udhëtimit për qëllim pune dhe kanë përqendrim biznesesh e shumëllojshmëri aktiviteteesh.

III.7.2. Reforma Territoriale & Administrative & studimi i dldp mbi zonat funksionale

Studimi i ZF nuk është një metodologji e re, po është një studim që është bërë dhe është testuar në vende të tjera. Ky studim u krye në periudhën shtator-dhjetor 2013 në pesë qarqet Dibër, Durrës, Kukës, Lezhë dhe Shkodër (ku do të fokusohet faza e tretë e dldp 2014-2017).

Objektivi kryesor ishte identifikimi i NjQV (ose grupe NjQV) si partnere të qëndrueshme të cilat mund të jenë në qendër të dinamikave të zhvillimit rajonal si dhe që mund të shërbejnë si modele për dhënien me efikasitet të shërbimeve.

Meqënëse qeveria shqiptare dëshironte të reduktonte numrin e NJQV-ve, me qëllim forcimin e kapaciteteve të NJQV-ve dhe reduktimin e kostove, qeveria ra dakord të përdorë dhe të përshtasë Studimin e Zonave Funktionale (SZF). Qeveria e ka njohur rëndësinë e këtij studimi dhe ka zgjedhur metodologjinë e zonave funksionale si kriter kyç strategjik për ndërmarrjen e reformës territoriale.

Studimi i dldp u fokusua në analizen e treguesve të ndërveprimeve të mëposhtme:

- 1) Nderveprimi institucional ndërmjet njesive vendore për shërbimet publike si menaxhimi i mbetjeve, ujësjellës, kanalizime etj;
- 2) Nderveprimi ekonomik, përfshirë: numri i bizneseve, diversiteti ekonomik, lëvizjet e forcës punëtore, potenciali i zhvillimit ekonomik, konsumi, cilësia e jetës dhe shërbimet;
- 3) Distanca dhe aksesimi drejt shërbimeve publike si: shërbimi shëndetësor dhe social, arsimit, transporti publik etj.
- 4) Numri dhe dendësia e popullsisë

Gjetjet kryesore të studimit të DLDP përfshijnë:

i) Identifikimi dhe përshkrimi i modeleve kyçe gjeografike të zonave funksionale që ekzistojnë në pesë qarqet e marra në studim. U identifikuan tre tipologji kryesore të zonave funksionale:

- a) Modeli koncentrik: i rëndësishëm veçanërisht për zonat më të varfra dhe të izoluara, që kanë vetëm një qendër dhe disa NJQV të largëta malore në periferi, dhe që kanë pak ndërveprime.
- b) Modeli policentrik- është i rëndësishëm për qarqet më të mëdha të Durrësit dhe Shkodrës, ku bashkë-ekzistojnë qendra më të vogla me një qendër rajonale më të madhe;
- c) Modeli ndërkufitar - ekzistojnë me zona që ndodhen afër kufijve kombëtarë, rajonalë apo zonash me ndërveprime të shpeshta ndërmjet këtyre kufijve.

ii) Duke përdorur metodologjinë e zonave funksionale, bëhet i mundur identifikimi i zonave të reja me disa NJQV, të cilat do të plotësonin nevojat dhe kërkesat e qytetarëve në mënyrë më të suksesshme nëpërmjet një menaxhimi shërbimesh më efikas dhe më eficient, si rezultat i një bashkëpunimi të forcuar mes NJQV-ve ekzistuese apo bashkimi të tyre.

Koncepti i zonave funksionale është i vlefshëm dhe se mund të vihet në punë. Megjithatë, përjasja e përdorur nuk duhet të jetë një zëvendësim për vendim-marrjen demokratike; por studimi duhet përdorur si një mjet që përdoret për të lehtësuar politikë-bërjen racionale dhe me informim të gjerë.

III.7.3. Gjetjet dhe propozimet e studimit të dldp për Zonën Funktionale Durrës


Ky studim e klasifikoi Durrësin (se bashku me Shkodrën) si zone të modelit policentrik. Karakteristikat kryesore të këtij lloji të ZF përfshijnë:

- Ekzistenca e një qendre të madhe rajonale me një prurje të fortë të banorëve të rinj. Të dy qytetet e Shkodrës dhe Durrësit janë kryeqytete të rajoneve të tyre përkatëse dhe janë shumë të rëndësishëm për rrethin dhe rajonet si qendra ekonomike.

- Ndërkohë që qendra rajonale është shumë e fuqishme, ka gjithashtu nën-qendra më të vogla të cilat shërbejnë si një qendër për zonat e tyre rurale përreth. Në një mënyrë këto zona kanë dy qendra: kryeqytetin e madh të rajonit por gjithashtu një qytet qendër më të vogël të zonës ku njerëzit marrin disa nga shërbimet dhe përdorin tregjet lokale.

Ne funksion të reformës territoriale studimi prezanton disa zgjidhje për amalgamimin e NjQV-ve në njësi më të mëdha. Studimi ka shërbyer për të ndikuar në marrjen e vendimeve të rëndësishme politike d.m.th. të shkohet drejt NjQV-ve vërtet të mëdha rreth qendrës së madhe rajonale apo të identifikohen disa NjQV me karakter nën-rajonal, duke zgjedhur në këtë mënyrë forcimin e qyteteve më të vogla si qendra përkatëse për zonat përreth tyre.

Harta 2: Njesite e Qeverisjes Vendore te Qarkut Durres para RAT



Burimi. dldp

Per Qarkun e Durrës, studimi identifikoi si *version kryesor* organizimin në katër zona funksionale:

1. tre zona funksionale në rrethin e Durrës me qendrat përkatëse: a) Durrës (Durrës - Rashbull); Shijak (Shijak - Xhafzotaj-Gjepal-Maminas); dhe Manëz (Manëz, Sukth, Ishëm, Katund i ri).
2. një zone funksionale në rrethin e Krujës me qender perkatase Fushë Krujë (Krujë, Fushë Krujë, Cudhi, Kodër Thumanë).

Si ndërveprime përcaktuese për këtë propozim studimi identifikoi modelet e punësimit dhe konsumit, aksesit në shërbime, veçanërisht e rëndësishme për aksin Manëz-Sukth (te dyja tani pjesë e Bashkisë së Re Durrës). Gjithashtu, studimi identifikoi dhe diskutoi edhe *zgjidhjet e tjera*, si më poshtë:


1) Për Rrethin e Durrësit:

- Në vend të një ZF në Manëz-Sukth të ketë dy zona të ndara; një për grupin Manëz-Ishëm dhe një tjetër për Sukth-Katund i Ri. Megjithatë Sukthi është një bashki më e madhe në lidhje me popullsinë, disa nga fshatrat e Sukthit marrin shërbime në Manëz për shkak të vendndodhjes së saj qendrore dhe lidhjes.
- Disa fshatra të Katundit të Ri (p.sh. Rinia) janë ngushtësisht të lidhur me Durrësin për të gjithë shërbimet. Disa fshatra të Maminasit janë të lidhur më ngushtësisht me Manëzin se sa Shijakun.
- Fshatrat e Ishmit janë të lidhur me Bubqin (kryesisht fshatra tradicionale) për shkak edhe të një lidhjeje rrugore të përmirësuar.

2) Për Rrethin e Krujës:

- Tendencat demografike dhe ekonomike e vendosin qendrën e zonës funksionale në qytetin e Fushë Krujës ndërkohë që tradicionalisht dhe administrativisht (gjithashtu dhe për shkaqe historike) qyteti i Krujës mund të jetë qendra e ZF.
- Komuna e Bubqit është e lidhur me Ishmin por gjithashtu (ekonomikisht) me bashkinë e Vorës në rajonin e Tiranës.
- Komuna Nikël është pjesë e një zone funksionale me qendrën në Kamëz, rrethi i Tiranës.

Harta 3: Zonat Funksionale të Qarkut Durrës propozuar nga studimi i dldp



Rezultatet e studimit të dldp (si dhe të studimit të “ShtetiWeb” për ndarjen e re administrative-territoriale) u konsultuan dhe u krahasuan nga nga grupi i ekspertëve të projektit STAR

Instituti për Bashkëpunim dhe Zhvillim – Cooperation and Development Institute

Rr. Sulejman Delvina, Pall. Moskat, Shk.8-64, 1019, Tirana – Albania

T/F: +355 4 2203054 E: info@cdinstitute.eu W . <http://www.cdinstitute.eu>; <http://www.shtetiweb.org>

(mbështetur financiarisht nga qeveritë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Suedisë, Zvicrës, Italisë dhe PNUD-it) për reformen territoriale në përputhje me metodologjinë e hartuar sipas kriteve të miratuara nga Komisioni Parlamentar për Reformën Territoriale.

Propozimi i Ministrit të Ceshtjeve Vendore i bazuar në këto studime dhe konsultime mbi ndarjen territoriale këto dhe ndarja territoriale e Qarkut Durrës sipas Ligjit nr. 115/2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësisë të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë” 31.07.2014 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Tabela 4: Ndarja territoriale e Qarkut Durrës sipas RAT

		Propozimi i DLDP	Propozimi i Ministri të Ceshtjeve Vendore	Ligi nr. 115/2014
1	Rrethi Durrës	ZF Durrës, 2 njësi ekzistuese: <ul style="list-style-type: none"> • bashkia Durrës • komuna Rrashbull 	ZF Durrës, qender bashkia Durrës, 5 njësi ekzistuese: <ul style="list-style-type: none"> • Bashkia Durrës • bashkia Sukth • komuna Ishem • komuna Katund i ri • komuna Rrashbull 	ZF Durrës, qender qyteti Durrës, 6 NJA <ul style="list-style-type: none"> • Durrës • Sukth • Ishem • Katund i ri • Rrashbull • <u>Manez</u>
2		ZF Shijak, 4 njësi ekzistuese: <ul style="list-style-type: none"> • bashkia Shijak • komuna Xhafzotaj • komuna Gjepa • komuna Maminas 	ZF Shijak, qender bashkia Shijak, 5 njësi ekzistuese: <ul style="list-style-type: none"> • bashkia Shijak, • <u>bashkia Manëz</u>, • komuna Xhafzotaj, • komuna Gjepalaj • komuna Maminas 	ZF Shijak, qender qyteti Shijak, 4 NJA: <ul style="list-style-type: none"> • Shijak, • Maminas • Xhafzotaj • Gjepalaj
3		ZF Manëz, 4 njësi ekzistuese: <ul style="list-style-type: none"> • bashkia Manëz, • bashkia Sukth, • komuna Ishëm, • komuna Katund i ri 		
Krahasuar me funksionimin në organizimin aktual në pesë njësi të ndryshme të qeverisjes vendore, zona e re funksionale do të ofrojë shërbimet e veta për të njëjtin territor duke pasur një administratë më efikase dhe do të sigurojë një vendimmarrje më të shpejtë dhe administrim më efikas të territorit me një numër më të reduktuar funksionarësh vendorë.

IV.3.2. Industria Perpunuese


Masa kryesore e NjE perbehet nga ndermarrjet facon, ku vec Durresit, dallohen Sukthi dhe Rrashbulli. Ky sektor eshte dhe punedhenesi me i madh me nje total te vleresuar ne rreth 8,298 persona. Punesimi ne kete sektor luan rolin e valvules se clirimit per presionin social te zones dhe varet ekskluzivisht nga eksporti, kryesisht ne Italin fqinje. Keshtu qe cdo strategji zhvillimi mbeshtetur ne kete sektor i kalon kufijte e FA Durres, si dhe varet ne menyre te drejtperdrejte nga evolucioni i tregjeve nderkombetare dhe i situates ekonomike te vendit fqinje. Ne rastin

konkret e ardhmja e Italise si tregu porosites me i madh do te kushtezoje zhvillimet afatshkurtra ne kete sektor.

Ne perspektive afatmesme, qeveria po synon modelin e zhvillimit "U". Ketu hyne psh qepja / vendosja e komcave / ngjitja / etc – procese te githa me vlere te shtuar te ulet por ku Shqiperia ka avantazh komparativ ne koston e krahut te punes dhe te afersise se tregjeve. Ne kete qasje ndermarrjet fillojne ne piken me te ulet te U dhe zhvillohen ose: a) majtas drejt Research & Development; ose: b) djathtas drejt marketingut dhe shitjes nen logon e ndermarrjes shqiptare.

Sidoqofte bazuar ne intervistat qe ne kemi patur me biznesmene dhe me zyrtare te Zyres Rajonale te Punesimit kemi krijuar bindjen qe problemi me i madh qe kane ndermarrjet facon ne FA Durres te intervistuar eshte oferta e kualifikimeve te krahut te punes. Aktualisht tregu i punes nuk arrin te permbushe nevojat e ketyre industrive.

Grafiku 7: Pesha e NjQV ne industrine perpunuese te ZF Durres




burimi: adminstratat tatimore te NjQV-ve, llogaritjet e autoreve

IV.3.3. Transporti & magazinimi

Nga tabela duket qarte qe eshte Bashkia Durres me rreth 400 ndermarrje qe mbizoteron ne kete sektor. Duke marre parasysh profilin e aktivitetit dhe numrin mesatar te punonjesve per ndermarrje, egzistencen e portit te Durresit, te Hekurudhes dhe volumin e transportit per mallra dhe qytetare, sherbimet e logjistikës dhe te transportit ne nivel kombetar dhe nderkombetar behen faktor zhvillimi strategjik kryesisht per Bashkine Durres. Njesite e tjera administrative priten te perfitojne kryesisht ne punesim.

Grafiku 8: Kontributi i NjA te ZF Durres ne tregtine me shumice



burimi: adminstratat tatimore te NjQV-ve, llogaritjet e autoreve

IV.3.4. Akomodime & sherbimi ushqimor

Tek Akomodimi dhe Sherbimi Ushqimor bejne pjese dhe njesite ekonomike qe ofrojne sherbime per turistet vendas dhe te huaj. Sipas llogaritjeve tona bie qarte ne sy numri i madh i ketyre njesive eshte ne Durres, si dhe ne Rrashbull, egskluzivisht ne kete te fundit te vendosur ne zonen bregdetare. Duhet thene qe profili i njesive ekonomike turistike ne zonen bragdetare ne Durres dhe Rrashbull jane te orientuara drejt nje klientele vendore dhe nga rajoni, kryesisht ne sezonin veror (fakt qe mund te verifikohet dhe nga numri i ulet i te punesuarve per njesi) dhe me fuqi modeste blerese.

Ndersa Manza dhe Katundi i Ri figurojne me numer te vogel, eshte Ishmi qe bie ne sy me peshen relativisht te ulet te ketij sektori ne te gjithe ZF Durres.

Tabela 33: Numri i vizitoreve per sezon, dhe logjistika turistike ne pese NjA

rubrika / koha	Dimer	Vere	2011	2012	2013
Ishem vizitore	100	5000			
dhoma			0	0	0
shtreter			0	0	0
Rrashbull vizitore	N/A	N/A			
dhoma			750	800	800
shtreter			N/A	N/A	N/A
Sukth vizitore	N/A	20 000			
dhoma			N/A	N/A	N/A
shtreter			N/A	N/A	N/A
Manez vizitore		local*			
dhoma			N/A	N/A	N/A
shtreter			N/A	N/A	N/A
KiR vizitore	0	0			
dhoma			0	0	0
shtreter			0	0	0

Ne baze te vleresimit te kushteve aktuale te ketij sektori ne mendojme qe zhvillimet strategjike mund te perqendrohen ne Ishem (si zona me a pademtuar dhe me potencial me te larte per sherbime elitare) dhe ne turizmin brenda tokes gjate gjithë vitit. Per turizmin gjate gjithë vitit ka potencial shume te larte Sukthi, Katundi i Ri dhe Manza. Profili i sherbimeve mund te ndertohet rreth produkteve vendore si vera, djathi (ne kemi identifikuar dy “Ruge Vere” qe prekin tre komunat) dhe turizmit fetar (kemi identifikuar deri tani pese fshatra ne disa komuna ku bashkejetojne te pakten dy komunitet fetare te ndryshme).

Edhe për këto kater vitet e ardhëshme, Turizmi do të jetë një ndër prioritetet e Bashkisë. Performanca e turizmit dhe përmirësimi i shërbimeve e mbështetur nga politikat e ndjekura të Bashkisë Durrës, e vendos atë në vendin e parë të listës së kontribuesve të produktit turistik shqiptar. Hartimi i Planit Rregullues të qytetit i ka dhënë prioritet Turizmit me planifikimin e ndërtimit të Portit Turistik dhe ndërthurjen e Rikualifikimit të Vijës Bregdetare të qytetit dhe hapjen e plazheve të reja në veri të qytetit drejt zonës së Kallmit.

Tabela 34: Logjistika Turistike - NjA Durres

Nr i Hoteleve	Nr. Operatoreve turistike	Nr. Shtreterve
28	134	2,134

Nderkohe Komuna Ishem planifikon te zhvilloje pjesen e territorit ne breg te detit, dhe Bashkia Manez ne planin e saj urbanistik (te pa-aprovuar akoma), planifikon nje zone sherbimesh moderne ne funksion te fshatrave turistike te Ishmit.

Tabela 35: Fluksi i Pasagjereve ne dhe permes NjA Durres

Pasagjere / Viti	2010	2011	2012	2013
Shqiptare	436.207	501.731	474.117	442.617
Te huaj	267.791	231.955	208.331	178.747
Total	834.040	853.748	798.524	717.399

Burimi. Bashkia Durres

IV.3.5. Bujqesi (me Pyje, dhe Peshkim)

Edhe pse aktiviteti ekonomik "Bujqesi, Pyje, Peshkim" rezulton me vetem 1,3% te subjekteve te ZF Durres, per ne eshte shume i rendesishem per dy arsye kryesore. Se pari nje sasi shume e madhe e banoreve ne pese njesite (vec Durresit) merren me bujqesi edhe pse nuk figurojne si te regjistruar ne QKR. Shifra e madhe e te punesuarve te anoncuar nga Ministri Veliaj per 2015 konfirmon kete dukuri. Se dyti taksa mbi token bujqesore do te jete nje nga sfidat e bashkise se re. Toka bujqesore ne qarkun e Durresit kap 40,568 ha ose 5.8% te tokes bujqesore te vendit, prej tyre 19,456 ha ju takon njesive te zones funksionale te Durresit. Kurse toka jo bujqesore (fondi pyjor, kullosor e te tjera arrin ne 35,874,00 ha prej te cilave 14,239 ha ju takon njesive te zones funksionale Durres.

Totali i ekonomive aktive ne sektorin e bujqesise ne Qarkun e Durresit eshte 31,539, prej te cilave 14,111 jane ne ZF Durres dhe ne to jane te perfshire 32,900 familje me nje popullsi prej 144,030 banore, prej te cileve 62,834 jane te moshes 25-54 vjec. Nga totali i ekonomive aktive 21,696 ose 69% jane te aktivitetit "Bime & Blegtori", kurse 9,843 ose 31% jane te aktivitetit thjesht bime. Ne sektorin e "Pentarisë" jane ne aktivitet 10457 ekonomomi ose 33% e totalit te ekonomive.

Madhesia mesatare e fermes ne qarkun e Durresit eshte 1.14 ha (nga 1.21 ha qe eshte mesatarja ne shkalle vendi). Te ardhurat nga bimesia dhe blektoria ne qarkun e Durresit kapin rreth 6.9 miliard leke dhe zene 8.2% te te ardhurave qe jep ky sektor ne shkalle vendi. Nga 2,156 ndermarrje te agroperpunimit qe ka vendi, 196 ose 9.1% jane ne qarkun e Durresit dhe 34% te tyre ne ZF Durres.

Ne nivel NjA, bujqesia është shumë e rëndësishme për Komunitet të Ri dhe bashkitë e Manzës dhe Sukthit. Shumica e fermerëve u shesin produktet e tyre blerësve që do të udhëtonin në fermën e tyre nga Tirana ose Durrësit. Tregjet provizore mund të gjenden në Sukth për shitjen e produkteve bujqësore dhe shumica ndodhin gjatë fundjavave. Këto tregje

kanë tendencë për ti shërbyer perkohësisht popullsisë vendase por nuk duket të kenë aftësi për të tërhequr njerëz ose blerës nga rajone të tjera. Një praktikë shtesë konsiston në dërgimin e produkteve në tregun e Shkozetit ose në lehtësirat frigoriferike në Rrashbull. Tregu i Shkozetit përdoret nga fermerët që vijnë nga Manza, Sukthi, Katundi i Ri dhe Rrashbull.

Tabela 36. Toka Bujqesore per Njesi Administrative te ZF Durres - 2013

Njesia Vendore	Sip. e njesise ne km ²	Sip ne km ² /1000 banore	Sip e tokes bujqesore ne ha	Sip e tokes bujqesore ne ha/1000 banore
3	19	20	21	22
Durrës	39,9	0,2	2200,8	10,6
Manëz	52	4,5	2200,8	192,0
Ishëm	85,4	9,6	1693,6	190,3
Katund i Ri	66,4	4,2	3293,2	211,6
Sukth	45,8	1,7	2819,1	105,0
Rashbull	54,8	1,9	2952,8	101,4

burimi: Ministria e Bujqesise, llogaritjet e autoreve

Ne zonen funksionale Durres, ne teresine e zhvillimit te vet ekonomik, bujqesia do te jete nje sektor i rendesishem. Ne se ne Bashkine aktuale Durres deri tashme, nuk perfshihej asgje nga sektori i bujqesise, pas ndarjes se re territoriale pjesa e aktivitetit bujqesor do kete po ate peshe sa dhe sektoret e tjere ekonomike. Kjo jo vetem per faktin se siperfaqja ne administrim e tokes bujqesore qe perfshin kjo zone funksionale ze gati 37% te tokes bujqesore dhe 16% te tokes jo bujqesore (fondi pyjor, kullota etj) te qarkut te Durresit, por do te jete dhe gati 42% e popullsisë te perqendruara ne fshatra qe do te merren me kete aktivitet. Por akoma me e rendesishme eshte pesha qe do te zere kjo zone funksionale ne prodhimin brutto bujqesor. Ne tabelen e meposhme paraqiten te dhenat e te ardhurave bruto nga bimet dhe blektorja, per vitin 2013, ne mije leke, sipas njesive vendore qe perfshihen ne zona funksionale Durres :

Tabela 37. Te ardhurat bruto nga Bimet & Blektorja ne .000 ALL - 2013

	Bujqesi	Blektori	Totale	Mesatarja / ferme (Lek)
Sukthi	421 410	732 436	1 153 846	246 432
Rashbulli	253 111	423 345	676 456	229 867
Manza	311 240	358 233	669 473	220 456
Kat I Ri	209 632	543	210 175	176 345
Ishmi	167 840	221 489	389 329	158 790
Shuma	1 363 233	1 736 046	3 099 279	
<i>Ndaj Qarkut</i>	<i>48,20%</i>	<i>34,60%</i>	<i>36,10%</i>	

burimi: Ministria e Bujqesise, llogaritjet e autoreve

Sikunder duket nga te dhenat e mesiperme, ne sektorin e bujqesise kjo ZF ka dhene gati 48% te te ardhurave bruto ne shkalle qarku dhe 34.6% te te ardhurave bruto ne sektori i blektorise. Por



COOPERATION AND DEVELOPMENT INSTITUTE

kjo peshe nuk eshte ne kete nivel ne perpunimin e produkteve bujqesore e blektorale, sikunder duket dhe nga te dhenat e tabelës së mëposhme, po për të njëjtin vit, 2013 :

Tabela 38. Te ardhurat nga Perpunimi - 2013 (ne .000 ALL)

	Bujqesore	Blektorale	Totale
Sukthi	31 474	15 630	47 104
Rashbulli	19 843	10 235	30 078
Manza	17 344	11 560	28 904
Kat I Ri	9 745	10 448	20 193
Ishmi	7 430	8 642	16 072
Shuma	85 836	56 515	142 351
<i>Ndaj Qarkut</i>	<i>24,10%</i>	<i>23,90%</i>	

burimi: Ministria e Bujqesise, llogaritjet e autoreve

Sipas informacioneve te marra ne terren, ky nivel i ulet i shkalles se perpunimit te produkteve bujqesore e ka bazen ne thithja e prodhimit, si lende e pare, nga perpunues te fuqishem (psh qumeshtin nga kopania "Lufra" rrushin nga kantina "Skenderbeu etj).

Peshe te rendesishme ne kete zone funksionale ze dhe numuri i fermave, sikurse duket nga te dhenat e paraqitura ne tabelen e meposhme :

Tabela 39. Numri i fermave me bime arash

	B.Arash	Grure	Miser	Fasule	Perime	Patate
Sukthi	2 340	432	1 014	813	2 310	408
Rashbulli	1 861	176	654	488	1 277	184
Manza	2 080	560	1 230	917	2 068	467
Kat I Ri	840	211	370	328	477	308
Ishmi	437	78	254	165	269	211
Shuma	7 558	1 457	3 522	2 711	6 401	1 578
<i>Ndaj Qarkut</i>	<i>24,80%</i>	<i>19,60%</i>	<i>22,70%</i>	<i>21,10%</i>	<i>32,20%</i>	<i>24,40%</i>

burimi: Ministria e Bujqesise, llogaritjet e autoreve

Pra njesite perberese te kesaj zone funksionale kapin gati nje te kateten e numurit te fermave ne shkalle qarku per bimet e arave, por ajo qe eshte e rendesishme nder to eshte qe gati nje e treta e ketyre fermave (32.2%), jane ne sektorin e perimeve, qe perben nje baze te rendesishme te furnizimit te tregut turistik te kesaj zone funksionale. Intesiteti i punes ne kete zone funksionale del ne pah ne se shqyrtojme shpenzimet e fermes te cilat paraqiten ne tabelen e meposhme :

Tabela 40. Shpenzimet e Fermave ne Bujqesi - 2013 (ne .000 ALL)

	Plugime	Mbjellje	Korrje	Trasport	Ujitje	Pesticide	P.Kimike
Sukthi	2 643	1 438	1 522	4 320	830	5 868	24 560
Rashbulli	2 960	1 340	1 080	3 270	470	4 320	18 800
Manza	2 100	1 410	1 232	3 100	597	7 300	22 936
Kat I Ri	1 250	735	446	714	112	1 450	6 440
Ishmi	1 138	513	317	765	84	1 160	4 320
Shuma	10 091	5 436	4 597	12 169	2 093	20 098	77 056

Ndaj Qarkut	14,70%	9,20%	6,70%	24,40%	22,80%	36,60%	22,80%
-------------	--------	-------	-------	--------	--------	--------	--------

burimi: Ministria e Bujqesise, llogaritjet e autoreve

Ajo qe bie ne sy mga leximi i kesaj tabele eshte pesha specifike e ulet e mekanizimit te proceseve te tilla si mbjellja (9.2%) dhe korrija (6.7%). Burimi i kesaj situatë duhet kerkuar ne madhesia e fermes si siperfaqe toke ne dispozicion, Ne shkalle qarku rezulton se madhesia mesatare e fermes eshte 1.14 ha. Nga llogaritjet tona indirekte madhesia mesatare e fermes ne kete zone funksionale eshte 1.43 ha, me minimum mesataren e fermes se Komunes Ishem prej 0.91 ha dhe maksimum mesataren e fermes ne Sukth prej 1,61ha. Prej ketej terheqim konkluzionin se kjo njesi e re funksionale do te duhet te kete prioritet te zhvillimit ekonomik krijimin e fermave te medha bujqesore e blektorale ne menyre qe te rritet perdorimi i mekanikes bujqesore e per rrjedhoje te lehtesohet puna e gjkalle e fermerëve e te sigurohen rendimete me te larta.

Brenda sektorit te perimeve nje nendegje e rendesishme e tij eshte kultivimi i tyre ne sera. Ne tabelen e meposhme paraqiten te dhenat e serave ne zonen funksionale Durres :


Tabela 41. Serrat

Nr.	Njesia	Ferma	Siperfaqe (ha)	Serra me ngrohje (ha)		Serra diellore (ha)	
				Me xham	Me plasmas	Me xham	Me plasmas
1.	Sukthi	46	21	8.4	3	3.3	6.3
2.	Maneza	32	11			2.1	8.9
3.	Rashbull	19	6				6
4.	Katund i Ri	6	1				1
5.	Ishmi	-	-				
6.	Shuma	103	39	8.4	3	5.4	22.2
7.	<i>Ne % ndaj qarkut</i>	41.6%	38.4%	60.2%	42.6%	33.7%	47.4%

burimi: Ministria e Bujqesise, llogaritjet e autoreve

Sektori i serave eshte mjaft i shtrire ne kete zone funksionale dhe perben gati 42% te shtrirjes se tij ne nivel qarku. Ne menyre grafike siperfaqja e tokes nen sere per njesite vendore aktuale te zones funksionale Durres paraqitet ne grafiku i meposhtem :

Grafiku 9. Siperfaqja e serrave / NjQV te FA



burimi: Ministria e Bujqesise, llogaritjet e autoreve



COOPERATION AND DEVELOPMENT INSTITUTE

Intensifikimi i teknologjive te kultivimit te perimeve ne keto sera mbetet problem i te ardhmes, sepse ndersa ne Europe, psh rendimetri i domates ne sere eshte 55-60 kg/m², ne serat e kesaj zone merret mesatarisht nje rendimet 4-5 kg/m².

Tabela 42. Te ardhurat nga Produktet Bujqesore te Perpunuara - 2013 (ne .000 ALL)

	Vere	Raki	Gjalpe	Djathe
Sukthi	2 430	3 640	340	10 430
Rashbulli	1 840	3 290	298	8 489
Manza	724	4 300	413	9 650
Kat I Ri	340	6 400	317	4 790
Ishmi	450	8 123	267	3 444
Shuma	5 784	25 753	1 635	36 803
<i>Ndaj Qarkut</i>	<i>19,30%</i>	<i>25,50%</i>	<i>30,30%</i>	<i>37,10%</i>

burimi: Ministria e Bujqesise, llogaritjet e autoreve

Pemtaria. Ne kete zone funksionale, pemtaria eshte nje sektor ne zhvillim e siper, sikunder duket dhe nga te dhenat e tabelës :


Tabela 43. Gjendja numerike e pemtarise (ne 1,000 rrenje), viti 2013

Nr.	Njesia	Peme	Ullinj	Agrume	Pjergulla	Vreshta (ha)
1.	Sukthi	33	13	4	6	47
2.	Manza	39	16	6	14	63
3.	Rrashbulli	37	22	5	21	84
4.	Katundi i Ri	51	27	7	18	29
5.	Ishmi	59	37	9	29	36
6.	<i>Shuma</i>	<i>219</i>	<i>115</i>	<i>31</i>	<i>87</i>	<i>259</i>
7.	<i>Ne % ndaj qarkut</i>	<i>38.6%</i>	<i>44.3%</i>	<i>39.4%</i>	<i>41.8%</i>	<i>40.1%</i>

burimi: Ministria e Bujqesise, llogaritjet e autoreve

Shume fermere te kesaj zone jane perfshire ne "Skemat Kombetare" te mbeshtetjes sidomos per ullinjte dhe vreshtat, por spontaniteti individual po demton organizimin sidomos persa i perket sistemeve te vaditjes me pika, qe garanton prodhim te pervitshem dhe rendimente justifikuese.

Grafiku 10. Struktra e drufrutoreve - ZF Durres - ne %



burimi: Ministria e Bujqesise, llogaritjet e autoreve

Si perfundim, (nqs heqim "sherbimet" ku futen dhe adminstrata) ne ZF Durres bujqesia ofron shumicen e vendeve te punese per Sukthin (26,3%), Ishmin (31,6%), Katundin e RI (23,4% ose 0,6% me pak se industria) dhe Manez (53,5%). Dhe pse ne vlere absolute keto shifra mund te mos kene rendesi, aktiviteti i bujqesise mbetet jetesor per punesimin si dhe per ekonomine

familjare te ketyre zonave, kryesisht sic verehet tek shifrat e te vetepunesuarve dhe te kontribuesve familjare. Cdo politike ekonomike ne nivel ZF duhet te llogarise kete fakt.

Tabela 44. Rendesia e bujqesise per punesimin

Treguesi / Njesi Vendor	Durres	KiR	Rrashbull	Sukth	Ishem	Manez
Punesimi sipas degeve te ekonomise: bujqesi	2,5	23,4	20,9	26,3	31,6	53,5
Statusi i punesimit: te vetepunesuar dhe kontribues familjare	26,7	52,2	38,4	49	56	65

Burimi: Instatgis, llogaritjet e autoreve

Bibliografia

1. *Plani i investimeve Kapitale Janar 2011 - Dhjetor 2015 Komuna Rrashbull*
2. *Zhvillimi i Master Planit të Gazit të Shqipërisë, 19 Dhjetor 2014*
3. *Buletini Statistikor 2013, Bashkia Durres*
4. *Towards a Sustainable Development of the Tirana - Durres region, Tirana February 2002*
5. *Swot Analysis, Edmond Alite, June 2009*
6. *Fletorja zyrtare e Republikës së Shqipërisë, 30 Dhjetor 2013*
7. *Strategic Plan for Economic Development 2005 – 2015, Tirana 2006*
8. *KONFINDUSTRIA-PROJEKTI STAR, QERSHOR 2014*
9. *INSTATGIS*

V. PROFILI I SHERBIMEVE PUBLIKE LOKALE

Ne kete kapitull do te trajtojme sektorin e Uje / Kanalizimet; Rruget & Transportin Publik; Menaxhimin e Mbeturinave dhe Zhvillimin Urban & Rregullimin e Territorit. Menaxhimi i Mbeturinave eshte trajtuar me hollesi te vecante.

V.1. Furnizimi me Uje / Kanalizimet

UKD ShA Ujesjelles Kanalizime Durres eshte shnderruar ne 27 Dhjetor 2007 me numri i ceshtjes: CN-109836-12-07, ku kuota qe mbahej nga aksioneri i vetem Ministria e Ekonomise dhe Industrise te Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Durrës, u transferua ne pronësi të njërive vendore të zonës së shërbimit që përbëhet nga 5 bashki dhe 10 komuna. Aksioneret ne UKD jane si vijon:

AKSIONERI	% e Aksioneve
1. Bashkia Durres:	54.7
2. Bashkia Sukth:	6.7
3. Bashkia Manez:	2.5
4. Komuna Katund I ri:	4.3
5. Komuna Rrashbull:	7.2
6. Komuna Ishem:	1.0
7. Komuna Fushe - Kuqe:	2.399
8. Komuna Thumane:	4.6
9. Bashkia Shijak:	3.6
10. Bashkia Vore:	2.0
11. Komuna Gjepalaj:	1.6
12. Komuna Maminas:	1.9
13. Komuna Preze:	0.8
14. Komuna Xhafzotaj:	4.5
15. Komuna Bubq:	2.2

Nje kopje e organogrames ndodhe ne fund te dokumentit.

Shoqëria Ujësjetllës-Kanalizime Durrës aktualisht siguron shërbimin e furnizimit me uje dhe kanalizime për Bashkine e Durrësit, Sukth, Manez, Shijak, Maminas, Xhafzotaj 1 + 2, Ishem, Fushekuqe, Fushekruje, Katund i Ri, Preze, Bubq, dhe Gjepalaj. Sasia ditore e furnizimit per te gjithë sistemin eshte 74,000m³.

Te ardhurat (ne .000) nga ujesjellesi per 2013 ishin ALL 521,841,942 dhe nga Kanalizimet ishin ALL 120,499,744.


ShUKD administron dy sisteme të pavarura furnizimi me uje nga pellgjet ujëmbajtës në Fushë-Kuqe dhe në Fushë-Krujë:

- Prodhimi behet ne Fushe Kuqe (14,000 m³/dite ekuivalent i 18%) dhe Fushe Kruje (59,963 m³ /dite ekuivalent i 81%). Nje pjese shume e vogel - rreth 1% - blihet nga Kavaja);

- Matja behet ne kater dege nepermjet kater flowmetrave në pikat kyce të rrjetit për llogaritjen e sasisë të shperndarë në rrjetin kryesor.
- Llogaritja e konsumit behet tek konsumatorët fundore.

Nga sistemi ne Fushe Kuqe (FK) furnizohen Bashkia Durres, Ishem, Manez, Sukth, KiR dhe Rrashbull (si dhe Xhafzotaj 1 dhe Fushe Kuqe). Impianti ka karakteristiukat e meposhteme: a) 7 puse; b) Q mes= 760 l/sec; c) linja e trasmetimit eshte DN700; dhe, e) ka 54 pika marrese.

Harta 9. Mbulimi me sherbime i Shoqëria Ujësjetlës-Kanalizime Durrës



burimi: ShUK Durres

Te dhena te pergjitheshme

Popullsia qe furnizohet me uje eshte rreth 80 %, ndersa oret e furnizimit me uje/dite eshte mesatarisht 6 ore. Per me teper 20% te fshatrave / lagjeve nuk kane nje sistem furnizimi me uje. Pjesa e familjeve te lidhura me rrjetet e ujerave te zeza eshte mesatarisht 52 % ne qytet. Zona rurale nuk ka rrjet kanalizimi. Gjatesia dhe kushtet e tubave kryesore, rezervuareve, impianteve te trajtimit, etj: rreth 165 km. Ndersa gjatesia e rrjetit sekondar te tubacionit, numri i lidhjeve me shtepite eshte rreth 472 km.

Ndersa ne Fushe Kruje (nuk furnizon ZF Durres), ka: a) 3 puse; b) Q mes= 180l/sec; c) linje trasmetimi DN500, dhe d) gjashte pika marrese

Sipas ShKU Durres, sasia e faturuar sipas tipit te konsumatorit ndahet si me poshte:



COOPERATION AND DEVELOPMENT INSTITUTE

- Familje: 90%
- Kompani private: 8%
- Institucion shteteror: 2%

Humbjet ne total arrijne ne 61.1% per te gjithë ZF Durrës, sipas tabelës së mëposhteme.

Tabela 45: Prodhimi & Faturimi i ujit nga ShUK Durres - 2013

	Njesia Vendore	Sasia e Furnizuar (m3/dite)	Sasia e Faturuar (m3/dite)	Humbjet
1	Bashkia Durres	35,144	14,475	59%
2	Ishem	1,956	367	81%
3	Manez	1,808	425	76%
4	Sukth	5,880	1,002	83%
5	KiR	3,387	890	74%
6	Rrashbull	4,087	1,108	73%

burimi: ShUK Durres

Shkaqet e humbjeve ne sistem jane: a) Regjistrimi i pasaktë i sasise së ujit nga ujematësat e konsumatorëve; b) Inefiçensa në organizimin e procesit të leximit; c) Lidhjet e paligjshme në sistemin e ujësjellësin; dh) Rrjedhjet në sistemin e shpërndarjes:

Tabela 46: Lloji i Matjes

	Me matje (%)	Pa matje (%)	Tarife (%)
Familje	80	17	3
Institucion	86	12	2
Kompani Private	94	2	4

burimi: ShUK Durres

Sikurse shihet, jane akoma rreth 80% e familjeve dhe gati po aq institucione qe nuk kane mates ate konsumit te ujit.

Pasqyrat Financiare 2011 dhe 2012

Bazuar ne PF te vitit fiskal 2012, ne nje veshtrim te pare, KUZ Durres paraqet nje permiresim te ndjeshem te rezultatit dhe nje rritje te bilancit. Sdq, nje veshtrim me i detajuar i nuancon ndjeshem keto shifra.

Persa i perket Bilancit, ne Aktiv vihet re nje rritje per 10.9% e te Ardhurave te Arketueshme (nga ALL 2.36 MID ne ALL 2.62 MID). Kjo mund te shpjegohet me perkeqesimin e mbledhjes se pagesave. Permiresimit I aktivitet shpjegohet kryesisht permes ri-vleresimit te aktiveve afatgjata qe shkojne nga ALL 0.55 MID ne ALL 1.27 MID (thjesht nje ushtrim ne kontabilitet). Ne Pasiv bien ne sy rritja e detyrimeve ndaj punonjesve nga ALL 0.44 MiO ne ALL 13.5 MiO, por qe le te pandryshueshem totalin e detyrimeve ne ALL 3.8 MID. Ndersa EBITDA kapercen nga (ALL 134 MiO) ne 2011 ne ALL 343 MiO ne 2012. C'fare ndodhi ne 2012 ?

Pergjigjen na e jep Pasqyra e te Ardhurave (shpjegimet ne vazhdim jane ne ALL ,000). Se pari verejme nje rritje te eficiences. Shitjet neto rriten me 53% (shpjeguar eventualisht ne rritjen e sasise se ujit te faturuar) per te arritur ne ALL 668.7 MiO nga ALL 435 MiO. Nderkohe kostoja e materialeve e konsumuara ulet me 9.1% (nga ALL 532.6 MiO ne ALL 488 MiO). Eshte shume interesante 25-fishimi I kostos se amortizimit (nga ALL 14.9 MiO ne ALL 376.3 MiO) por qe mund te shpjegohet me ri-vleresimin e aseteteve afatgjata. Ndersa me ne fund, verejme qe eshte “subvencionimi i elektricitetit” per ALL 657 MiO qe e kthen ndermarrjen nga humbese ne fitimprures. Pa kete injeksion, EBITDA e 2012 do te ishte dyfish me e ulet se e vitit paraardhes - nga (ALL 130 MiO) ne (ALL 290 MiO).

Rritja e te hyrave vazhdon dhe ne 2013 dhe shoqerohet ne ulje te shpenzimeve operative ne vlere absolute. Sidoqofte viti fiskal 2013 mbyllet me nje humbje neto prej ALL 85.2 MiO kryesisht per arsy te shpenzimeve te larta financiare dhe njohja e borxheve te keqija (ALL 219 MiO).

Tabela 47: Te dhenat financiare per Ndermarrjen KUZ Durres

	Zerat e Pasqyres Financiare (ne ,000 ALL)	2011*	2012*	2013**
1	Te Hyrat	592,202,848	726,691,233	787,275,690
2	Shpenzimet Operacionale	839,433,746	1,175,327,582	975,743,961
3	Rezultati Operacional	(247,230,898)	(448,636,349)	(188,468,271)
4	Te hyra / Shpenzime Financiare	112,530,999	158,648,101	136,627,057
5	Fitim para Tatimit mbi Fitimin	(134,699,899)	367,453,499	(51,841,214)
6	Tatimi / Fitimi / etj	0	24,132,426	(33,341,382)
7	EBITDA	(134,699,899)	343,321,073	(85,182,596)

Burimet. Pasqyrat Financiare te UK Dures dhe llogarirtjet e Autoreve

* Per 2011 dhe 2012 jane perdorur Pasqyrat Financiare 2012.

**Per 2013 jane perdorur Pasqyra Financiare te Audituar per Periudhen Kontabel e mbyllur me 31 Dhjetor 2013, se bashku me Raportin e Audituesit

Per vitin 2013 eshte aplikuar struktura tarifore e meposhteme.

Tabela 48: Struktura Tarifore KUZ Durres per 2013

	Konsumoret / Tarifat	Tarife Uje i Pijshem (ALL / m3)	Tarife Ujrat e Perdorura (ALL/m3)	Tarife Sherbimi
1	Konsumator Familjar	58	35	100
2	Institucion Buxhetor	120	50	100

3	Ent Privat	120	50	100
---	------------	-----	----	-----

Planet strategjike per sektorin e Ujit dhe Kanalizimeve

Objektivi eshte reduktimi i Ujit Pa te Ardhura (humbjeve te ujit) si perqindje e volumit te ujit te prodhuar, nga 71.4% ne vitin 2013, ne 50% ne vitin 2018. Projekti me i rendesishem eshte marrëveshje midis Qeveria Shqiptare dhe Bankes Botërore per US\$ 85 milion, te perbere si me poshte:

- Komponenti 1: Rrjeti i Furnizimit me Ujë fokusuar në krijimin e Kapaciteteve të reja prodhuese por dhe në Rehabilitim rrjeti shpërndarjes. Investime Prioritare jane për Furnizimin me Ujë, ku futet financimi i linjës së re të furnizimit përfshire një stacion të ri pompimi në Fushëkuqe. Linja do të jetë e dedikuar vetëm për qytetin e Durrësit, ndërsa linja ekzistuese do të përdoret edhe për fshatrat rreth saj. Linja e re do te përmirësojë shumë shërbimin e furnizimit të qytetit dhe zonës së plazhit. Gjithashtu, synohet përmirësimi i furnizimit me ujë në të gjithë zonën rurale nëpërmjet ndërtimit të linjave të reja të transmetimit dhe rezervuarëve për çdo fshat.
- Komponenti 2: Rrjeti i Largim / Grumbullimit te Ujrave të Ndotura, fokusuar në ndërtimin e rrjetit sekondar dhe terciar. Investime do te fokusohen në Rrjetin e Kanalizimeve nëpërmjet të cilit synohet të përmirësohet dhe zgjidhet problemi i kanalizimit të ujërave të zeza të zonës së Durrësit, përfshirë dhe zonën e Plazhit. Qëllimi kryesor është ndarja e sistemeve të ujërave të bardha nga kanalizimet dhe rehabilitimi i linjave kryesore të transmetimit përfshire stacionet e pompimit. Gjithashtu do të mbulohen me rrjet kanalizimesh dhe zonat periferike informale si dhe zona rurale
- Komponenti 3- Mbeshtetje Institucionale fokusuar në rritjen e aftësive të UKD dhe stafit të saj për arritjen e qëndrueshmërisë financiare dhe ofrimin e një shërbimi të përballueshëm nga konsumatori. Komponenti i Zhvillimit Institucional, Fuqizimit të Menaxhimit të Kërkesës dhe Fuqizimit të Ndërmarrjes, nëpërmjet të cilit do të mbështeten politikat dhe reformat e Qeverisë në sektorin e Ujit. Këto Reforma do të përfshijnë përgatitjen dhe zbatimin e një Programi për Monitorimin e Kërkesës për Ujë. Ky i fundit synon zbatimin e një programi matjeje për qytetin e Durrësit duke përfshire si klientët familjare ashtu dhe matjen në pikat e lidhjes ne linjën kryesore, zbatimin e një fushate ndërgjegjësimit për mos shpërdorimin e ujit, mbështetjen e Njësisë se Monitorimit pranë DPUK, asistence teknike për mbështetjen dhe zbatimin e një modeli efektiv për furnizimin dhe shpërndarjen e ujit etj.

Masat:

- Rehabilitimi rrjetit shperndares se qytetit.
- Instalimi i matesave zonale ne rrjetin shperndares, ne pikat e marrjes nga transmisioni kryesor, depot etj (250 cope).
- Zevendesimi i matesave familjare me probleme (12,160 cope).
- Instalimi i matesave ne klientet e rinj familjare dhe me faturim aforfe (26,690 cope).
- Instalimi i matesave ne klientet private dhe institucionet buxhetore (96 cope).
- Kryerja e monitorimit te humbjeve dhe riparimi i humbjeve te dukshme.
- Kryerja e bilancit rutine te ujit ne sistem.
- Reduktim i ineficences se lexuesve dhe matjes bazuar ne teknologji te reja, instalim i

PDA-ve

- Riorganizim i administrimit të zonave të shitjes - bilanci i ujit

Procesi i përditësimit të të dhënave të klientëve dhe ngritja e modelit hidraulik priten të mbarojnë brenda 2015.

Tabela e mëposhtme përmbledh projektet e realizuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjes dhe Kanalizimeve.

Tabela 49: Projektet e KUZ ne Qarkun e Durrësit

Nr.	Projekti	Financuesi
1.	Furnizimi me ujë i zonës Kënetë, Durrës (Zona 8 - 14) (Shtesë Kontrate)	MPPT
2.	Furnizimi me ujë i zonës Kënetë, Durrës, zona 8 - 14	MPPT
3.	Furnizimi me ujë në zonën e ish - Kenetës (Lagja 14)	MPPT
4.	Furnizimi me ujë të fshatrave të Bashkisë Sukth (Hamallaj)	MPPT
5.	Impianti i trajtimit të Ujrave të ndotura faza II Kavajë, Ndërtimi i kanalizimeve për zonën e Golemit.	BE/IPA 2009
6.	Ndërtim KUB, Fshati Hamallaj, Bashkia Manëz.	MPPT
7.	Ndërtim KUZ dhe KUB në lagjet "Bulkëve dhe Lekasejve"	MPPT
8.	Ndërtimi i rrjetit kryesor të KUZ në zonën e plazhit të Golemit (Lot 1)	BE/IPA 2007
9.	Ndërtimi i Rrjetit të Jashtëm të Ujësjes për zonat e plazhit të Durrës-Kavajë nga pusshpimet e Rrogozhinës Loti III, Linjat e ujësjes	MPPT
10.	Ndërtimi i sistemit të ri të KUZ në zonën e plazhit të Durrësit dhe linja e dërgimit për në ITUP (Loti 2)	BE/IPA 2007
11.	Përmirësimi i furnizimit me ujë, fshati Shkallë	
12.	Projekti i Menaxhimit të Integruar të Ujit dhe Ekosistemit	GEF, EIB, Lux Development
13.	Rehabilitimi i tubacionit DN 700 mm në zonën e Fushë Kuqes	MPPT
14.	Rikonstruksioni i Linjës së Ujësjes Unazë, Bashkia Durrës	MPPT
15.	Rikonstruksioni i Ujësjes rajonal, Bubq	MPPT
16.	Rikonstruksioni i Ujësjes të fshatrave Lalëz, Bizë, Drraç, Shete, Rrotull	MPPT
17.	Shtimi i sasisë së ujit dhe sistemit të lidhjeve të abonentëve në linjën e ujësjes në Fushë Kuqe	MPPT
18.	Studim i Fisibilitetit dhe Projektet e detajuara për programin IPA 2007 të Komunitetit Europian në zonën Bregdetare (Kontrate e Lidhur).	MPPT
19.	Studim i Fisibilitetit të Ujësjes Durrës - Kavajë (Kontratë e Lidhur).	MPPT
20.	Studim Projektim për Furnizimin me Ujë të Zonave të Plazhit Durrës - Kavajë nga Pus shpimet e Rrogozhinës (Kontratë e Lidhur).	MPPT

Burimi: DPUK

V.2. Rrugët & Transporti Publik

Rajoni i Durrësit është një ndër rajonet që nderthuret më mirë me rrjetin rrugor krahasuar me rajonet e tjerat të Shqipërisë. Të gjitha komunat dhe bashkitë janë të lidhura mirë me njëra tjetrën. Autobuzët ose minibuzët ditorë punojnë në rajon. Shijaku ka çdo gjë më orë dhe çdo orë minibuze dhe autobuzë që shkojnë në Tiranë ose në Durrës kështu që lidhet direkt me Xhafzotaj, Rrashbullin, Durrësin dhe Sukthin.

Katundi i Ri ka autobuzë ditorë që shkojnë nga qendra e komunës në qytetin e Durrësit ose bashkinë e Sukthit. Këta autobuzë fillojnë nga ora 6:30 nga fshati i Qerretit, Komuna e Katundit

Instituti për Bashkëpunim dhe Zhvillim – Cooperation and Development Institute

Rr. Sulejman Delvina, Pall. Moskat, Shk.8-64, 1019, Tirana – Albania

T/F: +355 4 2203054 E: info@cdinstitute.eu W: <http://www.cdinstitute.eu>; <http://www.shtetiweb.org>



COOPERATION AND DEVELOPMENT INSTITUTE

te Ri dhe i fundit që shkon ne Sukth është në orën 15:30. Ndërsa autobuzët që nisen nga Durrësi për në Qerret në orën 7:00 dhe autobuzi i fundit për në Katund të Ri është në orën 17:00. Këta autobuzë punojnë vetëm për fshatrat e Qerretit, Jubës dhe qendrën e komunës së Katundit të Ri. Fshatrat e tjerë si Rinia, i cili është afër detit ka mënyrat e tij të transportit dhe nuk shkon në qendrën e komunës. Ata e përdorin komunën vetëm për të marrë ndonjë dokument zyrtar ose për të paguar taksat. Ata kanë kalim më të lehtë në Durrës.

Tabela 50. Itineraret e transportit ne ZF Durres

	Manez	Ishem	Sukth	Shijak	Katund i Ri	Durrës
Manez		Daily MB	Daily MB	Daily MB	Daily Via Sukth	Daily MB
Ishem	Daily MB		Daily MB	Daily MB	Daily Via Sukth	Daily MB
Sukth	Daily MB	Daily MB		Daily MB	Daily Bus	Dialy Bus/M B
Shijak	Daily MB	Daily MB	Daily MB		Daily Via Durrës	Dialy Bus/M B
Katund i Ri	Daily Via Sukth	Daily Via Sukth	Daily Bus	Daily Via Durrës		Daily Bus
Durrës	Daily MB	Daily MB	Dialy Bus/MB	Dialy Bus/MB	Daily Bus	

Burimi: dldp, llogaritjet e autoreve

Tabela 51. Rrjeti rrugor jashte qytetit Durres

DURRES	K/FLLAKE	RADIOSTACION(RR.STRATEGJIKE)	4
DURRES	DURRES	BISHT PALLE(RR.STRATEGJIKE)	7
DURRES 95%~14km / TIRANE 5%~1	DURRES	MARIKAJ	13
DURRES	KRUJE	QAF SHATME (RR.TURISTIKE)	26
DURRES	K/RRUGE KOMBETARE	BILAJ (RR.TURISTIKE)	3
DURRES	SHKOZET	SUPERSTRADE	1

Tab. 52: Linjat e Autobuzeve per transportin Urban - Bashkia Durres

EMERTIMI I LINJES	FIRMA OPERUESE	INTERVALET KOHORE	NUMRI I MJETEVE
Durres-Spitalle-Durres	IRI TRANS	8 minuta	8
Durres-Nishtulla-Durres	IRI TRANS	7.5 minuta (05:00-23:00)	7
Durres-Currila-Durres	IRI TRANS	30 minuta	3
Durres-Universiteti A.Moisiu-Durres	IRI TRANS	15 minuta	4
Durres-Plepa-Durres	MAREN BUSS	6 minuta (05:00-23:00)	12

Instituti për Bashkëpunim dhe Zhvillim – Cooperation and Development Institute

Rr. Sulejman Delvina, Pall. Moskat, Shk.8-64, 1019, Tirana – Albania

T/F: +355 4 2203054 E: info@cdinstitute.eu W . <http://www.cdinstitute.eu>; <http://www.shtetiweb.org>

**Tab 53. Rrjeti rrugor - Ishem**

Road Name		Length (km)			
Start	End	Regional	Communal	Length (km)	Asphalt (km)
Kryqezimi Shkafane	Kuratj			5	
Kryqezimi Shkafane	Qender Shkafane			6	
Kryqezimi Shkafane	Fushe Drac			6	
Kryqezimi Rrotull	Qender Rotull			1,5	
Fushe Drac	Drac Koder			3	
Kryqezimi Lalez	Kurataj			3	
Kryqezimi Lalez	Shetaj			10	
Qender Shetaj				2	
Kryqezimi Biz	Lagje Bush			2	
Rruga Ishem	Likmetaj			2	
Rruga Ishem	Gjuricaj			4	
Bregu Lumit	Kertushaj			2	
Kertushaj	Likmetaj			2	
Kertushaj	Gjuricaj			2	
Gjuricaj	Kullos			1	

*burimi: dldp***Tab 54. Rrjeti rrugor - Manez**

Road Name		Length (km)			
Start	End	Regiona 1	Communa 1	Length (km)	Asphalt (km)
Kulle	Boro			1,5	
Bore Kryqezim Fshatit Manez				1	
Qender Rade				2	
Qender Kamas				1,5	
Kryqezimi Fshati Manez				2	
Fshati Manez	Lagja Hoxhe			2	
Kryqezimi Shkalle	Fshati Shkalle			2	
Kryqezimi Hamallaj	Fshati Hamallaj			3,3	
Kryqezimi Harmath	Fshati Harmath			3,5	

burimi: dldp

Tab 55. Rrjeti rrugor – Katund I Ri

Road Name		Length (km)			
Start	End	Regiona I	Communa I	Length (km)	Asphalt (km)
Fllake	Katund Rinia			3	
Katund	Jube			5	
Jube s Siperme	Jube e Poshteme			2	
Katund	Jube e Siperme			2	
Kryqezimi Fshati Sukth	Radioestacion			3	

burimi: dldp

Tab 56. Rrjeti rrugor - Sukth

Road Name		Length (km)			
Start	End	Regiona I	Communa I	Length (km)	Asphalt (km)
Kryqezimi Perlat	Perlat Hamallaj			6	
Kryq Rrushkull	Kryq Hamallaj			4	
Qender Hamallaj	Qender Fshat			2,5	
Qender	Sukuth			3	

burimi: dldp

Tab 57. Rrjeti rrugor - Rrashbull

Road Name		Length (km)			
Start	End	Regiona I	Communa I	Length (km)	Asphalt (km)
Rrashbull	Xhafzotaj			7	
Xhafzotaj	Qender Pjeshkez			6	
Kryqezim	Bozinxhic			6	
Rrashbull				4	

burimi: dldp

V.3. Menaxhimi i Mbetjeve ne ZF Durres

Në nivel kombëtar – PKMM, Plani Kombëtar i Menaxhimit të Mbeturive 2010-2025 (PKMM) përcakton 12 zonat mbetjeve në nivel Qarku, dhe propozon zhvillimin e 12 Planeve Rajonale të Menaxhimit të Mbetjeve (nga një për çdo Qark) brenda 2014. Objektivi i PKMM është riciklimi / kompostimi i 25% të mbetjeve në 2015, dhe 55% të tyre në 2020. Kjo strategji është miratuar në vitin 2011, por duhet ri-pare duke pasur parasysh reformën territoriale. Nderkohe planet e qarkut Shkoder, Diber dhe Tirane janë miratuar. Për Durresin egziston një pre-feasibility study që ka qenë e para dhe është perfunduar në 2010.

Sasia më e madhe e mbetjeve urbane të gjeneruara është në qarkun e Tiranës dhe të Durrësit, e ndjekur nga qarku i Fierit dhe i Vlorës, referuar Regjistrin vjetor të prodhimit të mbetjeve urbane dhe inerte sipas bashkive dhe qarqeve, të mbajtur nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës. NjQV-të ne pergjithesi kanë dështuar për të siguruar qëndrueshmërinë financiare - asnjë nga njësitë e qeverisjes vendore nuk është në gjendje të sigurojë mbulimin e kostove ne menyre te pavarur.

V.3.1. Ne nivel rajonal – Plani Rajonal i Menaxhimit te Mbetjeve (PRMM)

Sipas pikës 8 të nenit 13 të Ligjit nr. 10 463, datë 22.9.2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”, plani rajonal i menaxhimit të integruar të mbetjeve hartohet nga Qarku Durrës dhe miratohet nga Këshilli i Qarkut Durrës (jo nga ARM Durrës), i cili më pas e dërgon për shqyrtim dhe miratim në Këshillin e Ministrave. Vetëm pas miratimit nga KM Plani hyn në fuqi dhe botohet.

Qarku i Durrësit ka përgatitur PRMM të tij, por ai nuk është miratuar ende nga Këshilli i Qarkut. Objektivat e përcaktuara në këtë PRMM për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në Rajonin e Durrësit janë: a) të bëhet grumbullim i diferencuar për 20 % të mbetjeve brenda 4 viteve që nga miratimi i Planit; b) të bëhet grumbullim i diferencuar për 30 % të mbetjeve brenda 7 viteve që nga miratimi i Planit, dhe c) të bëhet grumbullim i diferencuar për 50 % të mbetjeve brenda 10 viteve që nga miratimi i Planit. Nga komunikimet e deritanishme zyrtare nuk kemi informacion zyrtar nga Këshilli i Qarkut Durrës rreth hartimit të Projektplanit rajonal të menaxhimit të integruar të mbetjeve.


Ne pergjithesi, edhe pse strategjia aplikohet ne nivel qarku, roli i qarkut në financimin e menaxhimi te mbetjeve është shume i vogel. Investimet dhe kontraktimet në nivel vendor kryhen nga NjQV e nivelit te pare dhe janë të monitoruara vetem gjate procedures se prokurimit. Si pasoje eshte e pamundur të bëhet një analizë e qartë e fondeve te angazhuara.

Sa i përket landfilleve, është kryer një studim nga kompania austriake e konsulencës ASA dhe mbeshtetur nga IFC për përcaktimin e një vendi të përshtatshëm për ndërtimin e një landfilli bashkëkohor rajonal për Qarkun e Durrësit. Ky vend (Zona 16 e studimit, fshati Rade, Bashkia Manez) ndodhet në territorin administrativ të Bashkisë Manez. Me date 18.11.2014 Ministria e Mjedisit se bashku me Ministrine e Infrastruktures kane publikuar ne website te Agjencise se Prokurimit hapjen e thirrjes per oferta per dhenien me koncesion te Landfillit per Qarkun e Durrësit referuar nenit 48 të ligjit 125/2013 “Për koncesionit dhe Partneritetin Publik Privat”. Bonusi në procedurën për zgjedhëse konkurruese i jepet shoqërisë "Albania Landfill Energy" A.L.E”. Po kjo kompani ka marre ne 2012 nje leje per Grumbullim, Depozitim & Reciklim ne te njejtin vend ne Manez per “Vendgrumbullim mbetjesh urbane”.

Harta 10. Vendndodhja e fshatit Rade – Venddodhja 16



COOPERATION AND DEVELOPMENT INSTITUTE




burimi: studimi i Landfillit – Qarku Durrës

Instituti për Bashkëpunim dhe Zhvillim – Cooperation and Development Institute

Rr. Sulejman Delvina, Pall. Moskat, Shk.8-64, 1019, Tirana – Albania


T/F: +355 4 2203054 E: info@cdinstitute.eu W . <http://www.cdinstitute.eu>; <http://www.shtetiweb.org>

Harta 11. Hapesirat e zgjerimit eventual te Vendndodhjes 16



burimi: studimi i Landfillit – Qarku Durres

Harta 12. Burimet kryesore të mbetjeve: 6 qytetet dhe 4 zonat



burimi: studimi i Landfillit – Qarku Durres

Deri në ndërtimin dhe vënien në funksionim të këtij landfilli njësitë e qeverisjes vendore i depozitojnë mbetjet që krijohen në territorin e tyre administrativ (në vend-depozitimet e tyre të përkohshme sipas listës së paraqitur ne tabelen e mëposhtme). Këto sheshe të landfillleve (vend-depozitime të përkohshme) aktualisht administrohen nga vetë njësitë e qeverisjes vendore.

Tab 58. Mbledhja, Depozitimi i Mbetjeve ne ZF Durres

NjQV	Menyra e Mbledhjes / Pastrimit	Depozitimi
Bashkia Durrës	Bashkia Durrës ka 2 ndërrmarje pastrimi: NSHK Durrës për zonat qyteti Durrës+Spitalle dhe NK Plazh për zonat Plazh+Shkozet.	VGM e Porto Romanos e miratuar vite më pare me vendim të këshillit bashkiak dhe prefekturës Durrës
Bashkia Manëz	E kryen vetë menaxhimin e mbetjeve, nëpërmjet Drejtorisë së Shërbimeve	Verçok / Ish Miniera Manez, Bashkia Manez
Bashkia Sukth	50% e kryen vetë Bashkia nëpërmjet Drejtorisë së Shërbimeve dhe 50% shoqëri private e nënkontraktuar - AFA Group	Vardardhë, Bashkia Sukth
Komuna Rrashbull	E kryen vetë grumbullimin dhe transportin e mbetjeve, nëpërmjet Drejtorisë së Shërbimeve.	Porto Romano, Durrës
Komuna Katund i Ri	E kryen grumbullimin dhe transportin e mbetjeve me shoqeri private të nënkontraktuar DU&CO shpk	Porto Romano, Durrës
Komuna Ishem	E kryen vetë menaxhimin e mbetjeve, nëpërmjet Drejtorisë së Shërbimeve	Kthesa e Rrotullës, Komuna Ishem

burimi: Agjencia Rajonale Qarku Durres

Në qarkun e Durrësit llogaritet se një banor i tij “prodhon” 236 kg mbetje në vit, duke u bazuar në një popullsi prej 414,677 banorësh (përfshire dhe rrethin e Krujes). Me sasinë prej 140,755 tonë në vit mbetje urbane, qarku bregdetar ka 12.4 për qind të sasisë vjetore në shkallë vendi, duke u renditur pas qarkut të Tiranës. Pas Durrësit vijnë qarqet e Fierit dhe Vlorës.

Tabela 59: Mbulimi me shërbime Mbetje per Bashkine e Re Durres

	Vitet	2011	2012	2013
Ishem	Nr i familjeve	2 500	2 960	2 980
	Nr. i familjeve që i ofrohet shërbimi	1 100	1 150	2 000
Rrashbull	Nr i familjeve	5 562	5 713	5 821
	Nr. i familjeve që i ofrohet shërbimi	4 450	4 507	4 562
Durres	Nr i familjeve	61 177	61 769	62 757
	Nr. i familjeve që i ofrohet shërbimi	61 177	61 769	62 757
Manez	Nr i familjeve	2 490	2 510	2 540
	Nr. i familjeve që i ofrohet shërbimi			
Sukth	Nr i familjeve	6 000	6 200	6 400
	Nr. i familjeve që i ofrohet shërbimi	6 000	6 200	6 400
KiR	Nr i familjeve	3 470	3 550	3 600



	Nr. i familjeve që i ofrohet shërbimi	3 400	3 500	3 500
--	---------------------------------------	-------	-------	-------

Burimi. Te dhenat nga NjA, Llogaritjet e Autoreve

Tabela 60. Profili I Mbetjeve Urbane - Bashkia e Re Durres

	Vitet	2011	2012	2013
ishem	Mbetje urbane	1800	2000	2190
ishem	Mbetje inerte	ska	ska	ska
ishem	Mbetje spitalore	1	1	1,2
ishem	Mbetje urbane	20	60	100
rrashbull	Mbetje inerte	4 000	4 000	4 000
rrashbull	Mbetje spitalore	ska	ska	ska
rrashbull	Mbetje urbane	ska	ska	ska
rrashbull	Mbetje inerte	ska	ska	ska
durres	Mbetje spitalore	54 750	44895	31463
durres	Mbetje urbane	ska	ska	16,665
durres	Mbetje inerte	NA	NA	NA
durres	Mbetje spitalore	ska	ska	ska
manez	Mbetje urbane	2050	2100	2190
manez	Mbetje inerte	ska	ska	ska
manez	Mbetje spitalore	30	33	35
manez	Mbetje urbane	ska	ska	ska
sukth	Mbetje inerte	13000	13500	14000
sukth	Mbetje spitalore	ska	ska	ska
sukth	Mbetje urbane	ska	ska	ska
sukth	Mbetje inerte	ska	ska	ska
kir	Mbetje spitalore	2880	2880	2800
kir	Mbetje urbane	ska	ska	ska
kir	Mbetje inerte	0,5	0,5	0,5
kir	Mbetje spitalore	ska	ska	ska

Burimi. Te dhenat nga NjA, Llogaritjet e Autoreve

V.3.2. Ne nivel lokal - Plani Lokal i Menaxhimit te Mbetjeve (PLMM)

Planet Lokale hartohen dhe miratohen nga Bashkitë dhe Komunat, të cilat në përputhje me Ligjin mbi Qeveritë Vendore, janë detyrë e Këshillave të Bashkive dhe Komunave respektive. Ne ZF te Durresit vetëm Bashkia e Durrësit ka nje PLMM. Asnje nga pese njesite e tjera nuk ka nje PLMM. Ne pergjithesi cilësia e ketyre planeve e diskutueshme mbasi nuk rrjedhin nga plani rajonal - ne rastin e Bashkise Durres PRMM nuk eshte i aprovuar. Per pese njesite e tjera kemi

vene re qe nuk ka kapacitetet në nivel lokal për të hartuar planet vetë dhe si pasoje planifikimi në nivel lokal mbetet subjekt i mbështetjes së donatorëve. Mesatarisht, një familje në qytetin e Durrësit prodhon rreth 2 ton mbetje në vit ose 5.5 kg mbetje në ditë (sipas llogaritjeve të bazuara në të dhënat e marra nga Bashkia e Durrësit).

Bashkia e Durrësit është Autoriteti kryesor përgjegjës për shërbimet e menaxhimit të mbetjeve në Durrës dhe ajo i kryen këto shërbime nëpërmjet dy Ndërmarrjeve të saj të Shërbimeve Komunale: 1) Ndërmarrja e Shërbimeve Komunale Durrës (NShKD), dhe 2) Ndërmarrja e Shërbimeve Komunale Plazh (NShKP). Të dyja ndërmarrjet drejtohen nga Këshilli Bashkiak, dhe financohen kryesisht nga buxheti i Bashkisë. Ato janë përgjegjëse për pastrimin e qytetit, grumbullimin e mbetjeve, dizinfektimin, mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbra, ndriçimin rrugor dhe varrezave publike, ofrimin e shërbimeve funerale, dekorin e qytetit si dhe planifikimin/monitorimin e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve.

Të dyja ndërmarrjet kanë të punësuar rreth 129 punonjës (numër ky që rritet deri në 154 gjatë sezonit të lartë), përdorin rreth 23 makina (për grumbullimin dhe transportimin) dhe mbi 1,055 kontenierë me një kapacitet total prej 1,160m³, siç është paraqitur në tabelën 8. Mesatarisht ka pese kontenierë për 1,000 banorë. Mbetjet hiqen nga 506 pika të grumbullimit të mbetjeve (ku mesatarisht ka 2 kontenierë për PGM), dhe mbetjet e hequra nga një kontenier janë mesatarisht 263 kg/ditë.

Te transportimi punojnë 75 punonjës (61 punonjës tek NShKD dhe 14 punonjës tek NShKP) të cilët përdorin 23 makina (10 agregatë, 10 kamionë, 2 kamioncina dhe 1 zeter) që transportojnë mbetje mesatarisht nëpërmjet 2 rrugësh në ditë siç tregohet në tabelën 10 më poshtë sipas llogaritjeve të kryera nga NShK-të. Gjatë 10 viteve të fundit të paktën nuk ka patur asnjë ndryshim në numrin e makinave. Në çdo pikë grumbullimi të mbetjeve punojnë 3 punëtorë. Gjatë 10 viteve të fundit të paktën nuk ka patur asnjë ndryshim në numrin e makinave.

Gjate vitit 2013 ne Porto Romano (Vendi i Grumbullimit te Mbeturineve) jane depozituar ne total 102,221 m³ ose 64,377 ton. - volum i cili eshte perlllogoritur i kompaktuar (koficienti i kompaktimit eshte marre 1 me 5 qe do te thote se 1 m³ i kompaktuar ose i ngjeshur peshon 625 kg perlllogoritur kjo peshe sipas VKM nr 175 date 19.01.2011 per qytetin e Durrësit). Keto mbetje ndahen si me poshte:

- mbetje urbane (Urbane dhe te gjelbera) gjithsej = 96,036 m³ ose 60,021 ton.
- mbetje dhera, inerte = 1,153 m³ ose 1845 ton.
- mbetje leshterik = 5,022 m³ ose 2511 ton.

V.3.3. Vend-hedhja e Porto Romanos

Vend-hedhja e Porto Romanos është i vetmi vend asgjësimi që përdoret në Durrës. Ai është funksional që prej vitit 1994 dhe ndodhet në zonën industriale, 4-5 km në Veri e cila është hapur që në fillim të viteve 90 dhe që është parashikuar të ketë jetëgjatësi për 25 vjet, deri ne 2015. Kostot për menaxhimin e mbetjeve ne PR (pastrimi, grumbullimi, transporti dhe asgjësimi) mbulohen nga buxheti i bashkisë së Durrësit.

Vendhedhja është organizuar në 3 parcela dhe mbulon një sipërfaqe prej rreth 200,000 m². Ajo pozicionohet në një zonë mjedisore sensitive - në një ligatinë që shpesh gjatë sezonit të shirave përmbytet. Ligatina ndodhet pothuaj në nivelin e detit dhe shtrihet përafërsisht mbi rreth 30 km² në drejtimin Veri-Jug, paralel me vijën bregdetare. Gjithë sasia e mbetjeve bashkiake të pa ndara, një përzjerje e mbetjeve të rrezikshme me mbetjet e parrezikshme, mbetjet spitalore dhe

mbetjet industriale së bashku me mbetjet inerte, përfundojnë në këtë vendhedhje, duke mos ndjekur asnjë standart mjedisor.

Ndërmarrja ka 5 punëtorë në vendhedhje, që punojnë me një buldozier totalisht të amortizuar. Mbetjet transportohen nëpërmjet një rruge të vogël të landfillit, hidhen aty dhe lëvizin me buldozier. Shumë pjesë të landfillit nuk janë të disponueshme si rezultat i përmytjes. Punëtorët thjesht i mbulojnë këto zona duke hedhur mbetje të tjera mbi to. Nuk ekzistojnë paisjet bazë dhe makineritë, siç është për shembull kompaktori (ngjeshësi). Zona e shpërndarjes nuk ka urë peshore, si rrjedhim, operatori (NSHKD) mund vetëm të përllogarisë sasinë e mbetjeve të dërguar në vendhedhje në bazë të numrit ditor të rrugëve që bën një kamion, vëllimit të kamionit dhe standarteve që përdoren për normat e konvertimit.

Sasia reale e mbetjeve të asgjësuar në vit në Durrës perlllogaritet të jetë në shkallën nga 63-67,000 ton. Në vitin 2009, sipas të dhënave të ofruara nga Bashkia e Durrësit, janë depozituar 101,507 ton mbetje.

Ne 2013, përveç NSHK Durrës që ka depozituar një total prej 64,377 ton mbetje urbane, dhera & inerte dhe leshterik (2,511 ton leshterike), dhe subjektet e mëposhtem të ZF Durrës kanë depozituar:

- N.K. Plazh: 22,754 m³ nga të cilat (mbetje urbane 18,000 m³, 112 m³ dhera, 4642 m³ leshterik) të konvertuara në total 14,335 ton.
- Komuna Rashbull: 3,560 m³ mbetje urbane ose 2225 ton.
- Autoriteti Portual Durrës: 3,400 m³ mbetje urbane ose 2125 ton
- Fjona 2006 shpk (kryesisht për mbetjet në Port): mbetje urbane 564 m³ ose 352 ton.
- Privat të ndryshëm: 252m³ mbetje urbane ose 157 ton.
- Komuna Katundi i Ri: 304 m³ mbetje urbane ose 190 ton .

Vendhedhja është pronë shtetërore nën zotërimin e Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës dhe administrohet nga Bashkia e Durrësit, megjithatë ajo ende nuk është regjistruar në regjistrin themelor të pronave-hipotekë.

V.3.4. Tarifat e mbledhjes - familjare

Aktualisht Durrësi aplikon një nivel tarife pastrimi simbolike për familjet: 1,000 ALL në vit për vitin 2009, duke qenë të paktën 5 herë më e ulët se tarifa që aplikon Tirana. Mesatarja e të ardhurave në Shqipëri është rreth 37,150 ALL/familje/muaj ose 445,800 LEKË/familje/vit. Sipas standarteve të KE-së, përqindja e përbalueshmërisë së tarifave për mbetjet është në nivelin 0.8% e të ardhurave neto. Në qoftë se do aplikohet këtë përqindje, tarifa vjetore për pastrimin do të ishte 3,566.4 ALL/familje. Sipas standarteve të vendeve të zhvilluara, përqindja e përbalueshmërisë së tarifave për mbetjet është 1.2% e të ardhurave neto. Në qoftë se do të aplikohet këtë përqindje, tarifa vjetore për pastrimin do të ishte 5,349.6 ALL/familje.

Nga 49,000 familje për të cilat realizohet shërbimi i menaxhimit të mbetjeve në Durrës, bashkia llogarit në planifikimin e saj vetëm 30,000 familje për të paguar tarifën e pastrimit.

Tabela 61. Tarifat e pastrimit për familjet dhe përqindja e mbledhjes nga NjQV, Viti 2014

	NjQV	Tarifa Vjetore (ALL)	% e mbledhjes

Instituti për Bashkëpunim dhe Zhvillim – Cooperation and Development Institute

Rr. Sulejman Delvina, Pall. Moskat, Shk.8-64, 1019, Tirana – Albania

T/F: +355 4 2203054 E: info@cdinstitute.eu W: <http://www.cdinstitute.eu>; <http://www.shtetiweb.org>

1	Ishem	2,400	20
2	Rrashbull	500	17
3	Sukth	1,000	66
4	Manez	1,500	80
5	KiR	500	90

Burimi. NA respektive, llogaritjet e autoreve

V.3.5. Pikat e dobeta te menaxhimi te mbetjeve

Pikat e dobeta ne menaxhimin e mbetjeve lidhen kryesisht me mungesen e planeve ne nivel rajonal, amortizimin dhe rrezikshmerine e Porto Romanos, si me poshte:

- Mungesa e PRMM Per Qarkun e Durrës;
- Mungesa e lidhjes se PLMM te Bashkise Durrës me PRMM;
- Mungesa e PLMM per pese NJQVte;
- PLMM nuk trajton strategjinë e Durrësit për menaxhimin e mbetjeve jo urbane, duke përfshirë këtu mbetjet e rrezikshme, ato nga ndërtimet dhe mbetjet portuale;
- Shkallen shume te ulet te ri-ciklimit;
- Vendhedhja e Porto Romanos nuk ka: a) shtresë mbrojtëse për ujin për të shmangur penetrimin nëntokësor të lëngjeve që rrjedhin në lëndfill; b) barriera kufitare; c) sistem grumbullimi për infiltrimin e mbetjeve; d) impiant të grumbullimit të ujrave sipërfaqësore (për ujin nga shiu); e) rrjet për të mbledhur biogazrat; f) mbulim ditor të mbetjeve për të shmangur erërat dhe djegien e mbetjeve; g) rrjet rrugësh të brendshme; h) zyra në vendhedhje; i) impiant për ndarjen manuale të mbetjeve. Gërmuesit e mbetjeve qëndrojnë në majë të mbetjeve për të ndarë rrymat e mbetjeve që ju interesojnë; j) rrethim me gardh të fushës; k) akses të kontrolluar; dhe as l) sistem peshimi.

Tab 62. Lejet e Miratuara per 2012- 2014 per Grumbullim, Depozitim & Reciklim

ZF Durrës

Subjekti	Administratori	Aktiviteti	Vendndodhja	Viti
BAHITI PLAST	N/A	Grumbullim ,transportim, riciklim mbetjesh plastike	Porto Romano Durrës	2014
SOMET		Eksport Mbetje plastike	Shkozet, Durrës	2013
SHIGJETARI-B	Bashkim Hushi	Grumbullim dhe depozitim i vajrave te përdorur, lubrifikanteve	Pranë ish-SMT Shijak, Durrës	2013
SERXHO	Serxhio Zeqja	Impiant grumbullimi dhe trajtimi i automjeteve ne fund te jetës	Fshati Bisht Kamez, komuna Katund I Ri, qarku Durrës	2013
Pastrimi Detar	Ilir Karagjozi	Mbetje portuale III.2.B	Durrës	2013
Shijaku	Shpëtim Shijaku	Mbetje Skrapi III.2.B	Durrës	2013
Gjyzeli	Bujar Gjyzeli	Riciklim vaj i përdorur	Durrës	2013
Albasud Service	Alfredo Suares	Grumbullim Vaji	Shkozet, Durrës	2013
Essen	Rado Brajoviq	III.2.B Grumbullim, përpunim skrapi	Durrës	2013

Instituti për Bashkëpunim dhe Zhvillim – Cooperation and Development Institute

Rr. Sulejman Delvina, Pall. Moskat, Shk.8-64, 1019, Tirana – Albania

T/F: +355 4 2203054 E: info@cdinstitute.eu W: <http://www.cdinstitute.eu>; <http://www.shtetiweb.org>



COOPERATION AND DEVELOPMENT INSTITUTE

ITAL-LUBRIFICANTI	Arbino Girardi	Grumbullim vajrash te përdorur	Durrës	2013
Ital Lubrificanti	Arbino Girardi	III.2.B.Grumbullim vaji	Rrashbull, Durrës	2013
Albasud Servise	Alfredo Suarez	III.2.B.Grumbullim vaji	Durrës	2013
Scholz	Arsim Muja	K.III.2.B. Grumbullim, përpunim skrapi	Rrashbull, Durrës	2013
La Vitoria	Rino Di Fiore	Depolimerizim, riciklim gomash	Porto Romano, Durrës	2012
Dawa International Trade	Xi Wang	Perpunim mbetje plastike	Rrashbull, Durrës	2012
Albania Landfill Energia A.L.E.	Arjan Xhiani	Vendgrumbullim mbetjesh urbane	Manze, Durrës	2012
Somet	Besnik Kryekurti	Kat. III.2.B. Riciklim baterish	Shkozet, Durrës	2012
Edipack	Elsa Balteza	Grumbullim, riciklim letre, prodhim letre	Spitalle, Durrës	2012

Burimi: Agjencia Kombetare e Mjedisit

Bibliografia

1. NDERMARRJA E SHERBIMEVE KOMUNALE ANALIZA VJETORE E PUNES PER VITIN 2013
2. LANDFILLI I ZONËS 2, MANZE. (QARKU DURRES), TRAJTIMI PËRFUNDIMTAR I MBETJEVE TË NGURTA.
3. *Plani Lokal i Menaxhimit të Mbetjeve për Bashkinë e Durrësit 2010-2025*
4. *Studim për percaktimin e territorit për asgjësimin e mbetjeve të ngurta (Lendfillit Sanitar në Durres, Shqipëri), RAPORTI FINAL 18.05.2011*
5. *Lejet e Miratuara për 2012- 2014 për Grumbullim, Depozitim & Reciklim ZF Durres, Agjencia e Mbrojtjes së Mjedisit*
6. *Municipal waste management in Albania, Arta Kodra, Nentor 2013*
7. *The main pollutions in Durres city and the impact on population health*
8. *Mbetjet 2013, Durres*
9. *Menaxhimi i Mbetjeve në Shqipëri, Prof. Dr. Pellumb Abeshi*
10. *Problemi i ndotjeve në Durrës, drejt zgjidhjes, Gazeta Telegraf*
11. *Vlerësimi Strategjik Mjedisor i Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Durres, Dhjetor 2012*

V.4. Planifikimi urban dhe menaxhimi i tokës në ZF Durres

Ne lidhje me menaxhimin territorial, vihet re se panorama bregdetare e ZF Durres ka degraduar shpeshherë me ndërtime të realizuara në mungesë të një planifikimi kombëtar e ndërsektorial. Gjithashtu, kjo zonë vuan parcelizimin e planifikimit, aty ku kompetencat dhe juridiksionet territoriale ndahen.

Per arsye të pozicionit të saj gjeografik ZF Durres është pjesë e Planit të Integruar Ndërsektorial për bregdetin (PINS) që do të shërbejë si sistem rregullues për të siguruar standarde në planifikim dhe garantimin e instrumentave që mundësojnë shërbime cilësore turistike. Këto mungesa kanë rënduar situatën në terren, duke degraduar panoramën e bregdetit. Vizioni që do të përcaktojë Plani i Integruar Ndërsektorial për bregdetin (PINS), do të vendosë një raport të drejtë dhe ekuilibra mes objektivave të zhvillimit sipas këndvështrimit të politikave të qeverisë, të drejtës për zhvillim dhe burimeve natyrore në territor. Ky proces do të ketë në fokus ndryshimin e gjendjes aktuale në zonën e bregdetit, duke ligjëruar e zbatuar një vision të ri, nëpërmjet aplikimit të instrumentave ligjore dhe urbane, që do të realizojnë sfidat, duke miradministruar potencialet e vendit dhe duke i dhënë hov të madh e cilësor zhvillimit të turizmit.

Gjithashtu, ZF Durres është pjesë e Planit Tiranë-Durrës i cili është pjesë integrale e Planit të Përgjithshëm Kombëtar. Tirana dhe Durrësi janë qytete që kanë patur një zgjerim në shtrirjen e tyre dhe tendenca është që këto qytete të takohen. Zona ndërmjet është një nga zonat që ka patur një zhvillim të vrullshëm formal dhe kryesisht informal. Zhvillimet kaotike dhe pa vizion kanë dëmtonuar rëndë peisazhin natyror, prandaj lind nevoja për një plan të integruar dhe me një vizion të qartë. Plani Tiranë-Durrës do të orientojë përdorimin dhe shfrytëzimin e kësaj zone si dhe do të krijojë infrastrukturën e përshtatshme për një zhvillim të qëndrueshëm.

Njesite vendore që kanë miratuar IPV në KKT janë Bashkia Durres dhe Komuna Ishem. Megjithatë zhvillime jo në përputhshmëri me planin e miratuar, evidentohen në bashkinë Durrës si dhe komunat Ishëm, të cilat kanë në vizionet dhe politika e zhvillimeve territoriale të tyre, rritjen e kapaciteteve të shërbimeve mbështetëse ndaj turizmit, agrikulturës, si pjesë

përbvrëse e ultvsirës perëndimore, rritjen e shërbimeve ekonomike te organizuara përgjate akseve të rrugëve kryesore urbane, të zonave periferie të banimi.


Rastet e bashkive dhe qyteteve të mëdha, që kanë dhe tendencë zhvillimi më masiv, shpesh rrezikojnë të kenë më pak transparencë në morinë e zhvillimeve të tyre. Ky fenomen përkthehet në abuzime të zhvillimeve informale siç shihet dhe nga statistikat e marra nga ALUIZNI, ku evidentohen konkretisht qytetet e mëdha, ato të cilat kanë numin më të lartë të ndërtimeve informale, si Durrësi, Tirana, Shkodra, Vlora, etj.

Nr i vetedeklarimeve ne 2013 per Qarkun e Durresit eshte 4,574. Në bashkëpunim me institucionet e tjera shtetërore, të njësive të pushtetit vendor, si dhe të subjekteve të interesuara, gjatë tremujorit të fundit të vitit 2013, I.N.U.K. ka kryer veprime për verifikimin e situatës ndërtimore si dhe ekzekutimin e vendimeve për prishje. Në mbështetje të I.N.U pranë bashkisë Durrës, janë ekzekutuar gjate viti 2013 dhe 2014: a) 13 vendime për prishje, dhe b) 6 Vendime për Dënim me Gjobë.

Zyra e ALUIZNI-t për qarkun e Durrësit ka shpërndarë me date 14 shkurt 2015, rreth 1050 leje legalizimi për banorët e qarkut, nga te cilat 620 per territorin e Bashise se Re Durres. Nderkohe eshte lajmeruar se po bëhen gati më shumë se 1000 leje të tjera që pritet të shpërndahen pas disa ditësh. Burime nga Agjencia thanë se në këtë zonë pritet të kryhen rreth 2500 legalizime. Drejtori i Përgjithshëm i ALUIZNI-t, Artan Lame, në nisje të takimit tha se “Qarku i Durrësit është një nga qarqet që ka më tepër ndërtime informale pas Tiranës, për shkak dhe të lëvizjes së madhe të njerëzve në gjithë këto vite¹”. Lejet e Legalizimit per Qarkun e Durresit te leshuara ne ne Shkurt 2015 jane: Durresi - 1; Katundi i Ri - 43; Rashbulli - 482; Sukthi - 17 dhe Manez - 77.

Harta 13. Shperndarje gjeografike (ne te verdhe) e Zonave Informale ZF Durres

¹ <http://www.mapo.al/2015/02/legalizimet-lista-me-1050-emra-per-durresin/>



Burimi. ALUIZNI

Ne total Bashkia Durres ka nje siperfaqe prej 1,420.00 ha ne Zona Informale / Vendbanime Informale nga te cilat 1,157.6ha i perkasin Bashkise Durres dhe 262,4ha i perkasin komunes Rrashbull.

Nder projektet urbane te miratuar ne PLMM Durres, mund te permenden:

- Rigjenerimi urban i zonës së Shkozetit (aktualisht miksi banim dhe industrie). Plan strategjik për një zonë me siperfaqe 100 ha parashikon ri-integrimin me rrjetin urban duke përfshirë banesa dhe njësi të vogla prodhimi (ndërmarrje në nivel familjar). Të gjitha aktivitetet e sektorit sekondar, të shpërndara në të gjithë qytetin përfshirë Shkozet, do të vendosen në Parkun Industrial
- Rigjenerimi urban i zonës së “Durrësit të Ri” (ish-Kënetës). “ Durrësi i Ri”: zonë rezidenciale me popullsi të re dinamike që ka nevojë për rinovim urban. Me projektet për rehabilitimin e infrastrukturës, si: “Ndërtimi i Sistemit të Furnizimit me Ujë”, “Rehabilitimi i Sistemit të Kanaleve të vjetra” duke i kthyer ato në rrugë të mirfillta, kjo zonë e re e qytetit do të ndërthuret me pjesën tjetër të qytetit, duke u bërë një trup i vetëm me sistemin e infrastrukturës së tij.
- Rikuperimi dhe ri-jetëzimi i qendrës historike të qytetit. Restaurim i Integruar ku, përveç aspekteve urbane dhe vlerave arkitektonike, do të merren parasysh edhe aspektet ekonomike dhe shoqërore të trashëgimisë kulturore;
- Integrimi i zonave të reja rezidenciale me zonat e vjetra në Porto Romano. Projekti i Unazës së Re të Qytetit ka për qëllim të kufizojë trafikun e automjeteve të rënda dhe një pjesë të trafikut të automjeteve private në zonën qendrore të Durrësit, që rrethon zonën kryesore të banimit në qytet.

- Studim fizibiliteti dhe reabilitim urban i zonës së plazhit përfshin “Rinatyalizimin e Kodër-Vilës dhe të “Brezit të gjelbër të qytetit”, i cili synon të shmange erozionin e mëtejshëm.
- Ne zona bregdetare mes Portit dhe Kavajës, bulevardet këmbësore do të zgjaten deri në zonën e shëtitorës në veri dhe në jug të qytetit të Durrësit, si drejt zonës së Currilave ashtu dhe drejt plazhit të Plepave.
- Rikualifikim i zonës pranë Portit, Projekti i rrugës “Mars 91” & Vija e kaltër” & rivendoseja e lidhjes qytet-det të munguar deri më sot në Durrës. Zona portuale do të jetë destinacioni për turistë të shumtë në të ardhmen, me një port me funksion turistik, zonë pushimi dhe vend për zhvillimin e eventeve të ndryshme kulturore. Porti ekzistues tregtar do të zhvendoset në Porto Romano, në mënyrë që Durrësi të presë varka me vela, jahte, anije të mëdha udhëtarësh dhe varka private sportive.
- Portit i peshkimit duhet të ndërthuret me Portin Turistik, ku cdo element i tij të jetë i mirëprojektuar dhe i detajuar në funksion të Turizmit dhe qytetit.

Po ashtu Keshilli i Qarkut Durres, Keshilli i Rregullimit te Territorit, vendosi me 0.11. 2008 per miratimin e masterplanit me objekt *“Zhvillimi i integruar (ne sinergji) i zones energjetike dhe industriale te Porto-Romanos, Durres, infrastruktura dhe konturet e saj”*.

Tabela 63. Vlera e Tokes sipas kategorive – Manez, Sukth dhe Rrashbull

BASHKIA/ KOMUNA	NJESI VENDORE/Fshatra	VLERA NDERTE SA (lek/m ²)	VLERA TRUALLI (lek/m ²)	VLERA TOKA BUJQESOR E (lek/m ²)	VLERA LIVADHE KULLOT A (lek/m ²)	VLERA TOKA PYJORE (lek/m ²)
BASHKIA MANEZ	BASHKIA MANEZ	40,400	786			
	ARMATH		739	408	177	21
	BORC		739	352	152	
	HAMALLAJ		369	447	194	
	KAMERAS		739	788	342	21
	KUCOK		2216	744	323	
	RADE		554	842	365	21
	SHKALLE		923	357	155	21
KOMUNA RRASHBULL	HARTE DWG		x	x	x	x
BASHKIA SUKTH	BASHK.SUKT H ZK 3542	41,500	2983	x	x	x
	VADADHE ZK 3690		647	339	151	x
	KULLE ZK 2321		x	339	151	x
	RRUSHKULL ZK 3241		2317	339	151	182
	HAMALLAJ ZK 1925		475	330	151	182

burimi: AKPT, llogaritjet e autoreve

Bibliografia

1. *Urban Planning & Land Management, Keshilli i Qarkut Durres, Keshilli i Rregullimit te Territorit*
2. *Agjencia Kombetare e Rregullimit te Territorit, Raporti Vjetor 2013-2014*
3. *Masterplani i Qendres te Durresit, 14 Shkurt 2007*
4. *Plani Struktural. Bashkia Durres, 20 Shkurt 2010*
5. *Politika e Planifikimit te Territorit, Bashkia Durres*
6. *Perzgjedhja e Fituesit per "Vijen Bregdetare te Jugut", dhe Korridorin Ekonomik Tirane – Durres, 19/11/2014, Gazeta Tema*
7. *Development Alternatives in Rural and Unfavourable Areas in the Coastal Area of Ishem - Porto Romano for a Sustainable Development, M. Sc. Shkëlqim Sirika, October 2013*
8. *Plani i Zhvillimit te Turizmit, Komuna Ishem, Qershor 2009*
9. ALUIZNI: http://www.aluizni.gov.al/wp-content/uploads/2014/12/ZONAT-INFORMALE_Page_2_PHOTOSHPED.jpg

VI. ORGANIZIMI I SHERBIMEVE TE PUSHTETIT VENDOR NE ZF DURRES

Sipas te dhenave te marra nga NjQV-te e ZF Durres, njesite vendore aktuale kane perberjen e meposhteme:

- Bashkia Durres: 238 punonjes (perfshire gjendja civile dhe QKR);
- Komuna KiR: 28 punonjes;
- Bashkia Manez: 26 punonjes;
- Bashkia Sukth: 46 punonjes;
- Komuna Rrashbull: 54 punonjes;
- Komuna Ishem: 40 punonjes.

Struktura aktuale e Bashkise Durres, e cila do te jete dhe qendra administrative e Bashkise se Re Durres, perfshin:

- Kryetarin;
- Kabinetin: 3;
- Sektori Marredheneve me publikun: 2
- Drejtoria e burimeve njerezore: ____20
- Drejtoria e planifikimit & kontrollit te zhvillimit te territorit: 23
- Drejtoria e taksave dhe tarifave vendore: 33
- Drejtoria e politikave te zhvillimit: __8
- Drejtoria ekonomike: _____17
- Drejtoria e arsim-kulture-rini-sport, komuniteteve fetare: 15
- Drejtoria e sherbimeve: _____11
- Drejtoria e sherbimit social: _____14
- Policia bashkiake: _____20
- Qendra Administrative Nr. I: ____3
- Qendra Administrative Nr. II: ____3
- Qendra Administrative Nr. III: ____3
- Qendra Administrative Nr. IV: ____3
- Qendra Administrative Nr. V: ____3
- Qendra Administrative Nr. VI: ____3
- Inspektoriati Ndertimor Urbanistik: 14

Perfaqesimi aktual i NjQV ne Keshillin e Qarkut eshte si me poshte:

- Bashkia Durres: ____8 perfaqesues
- Bashkia Sukth: ____3 perfaqesues;
- Bashkia Manze: ____3 perfaqesues
- Komuna KiR: ____3 perfaqesues;




COOPERATION AND DEVELOPMENT INSTITUTE

- Komuna Ishem: ____2 perfaqesues
- Komuna Rrashbull: __3 perfaqesues

VI.1. Profili dhe shërbimet kryesore të ofruara nga NjQV

Realizimi i objektivave të caktuara nga detyrimet ligjore për funksionet dhe shërbimet që duhet të ofrojnë njësitë vendore ndaj komuniteteve të tyre, varen në një shkallë të konsiderueshme nga niveli i arsimit dhe perkushtimi i vendimarrësve (keshillave bashkiakë apo komunalë) dhe në administratën vendore. Në se lexojmë me kujdes grafikun e mëposhtëm 5, del në pah se një ndër faktorët që kanë rezultuar të atraktive ndaj komunitetit të qytetit të Durrësit, është se në Keshillin Bashkiak 90% e antarëve janë me arsim të lartë. Por ka dhe raste kur perkushtimi dhe niveli i lartë i përgjegjshmërisë së Kryetarit të Bashkisë, minimizon efektin negativ të nivelit të ulët të arsimit, si në rastin e Bashkisë Manze, ku në administratë janë vetëm 28% me arsim të lartë dhe në keshillin bashkiak vetëm 41%.


Grafiku 11. Pësa specifike e arsimit të lartë në administratat dhe keshillat e ZF Durrës



Për një rol edhe më të madh në nivelin e shërbimeve komunitare luan edhe numri i burimeve njerëzore që meren në administratë dhe të punonjësve të shërbimit që njësitë vendore kanë në dispozicion.


E vërtetë është se për këto qëllime nuk ka një standart të përcaktuar në shkallë vendi ose sipas kategorive të njësive vendore e për rrjedhim nuk mund të gjykojmë kush i përgjigjet më mirë dhe kush më dobët. Për në grafikun 6 rezultojnë që nivelin më të mirë e ka komuna Ishem, bile edhe ndaj bashkisë Durrës. Kjo është rrjedhojë e sistemit të përcaktimit të numrit nga fondi i pagave i cili është i limituar dhe kontrolluar edhe nga qeveria qendrore si kontribues në grant. Prandaj në kuadrin e ZF duhet të përcaktohet fillimisht cili do të jetë standarti, pra sa punonjës të administratës dhe sa punonjës shërbimi duhet të jenë në një zonë funksionale, që ajo të realizojë standartin (e mundur) edhe të shërbimeve ndaj komunitetit. Në funksion të kësaj më pas do të bëjmë një krahasim për të kuptuar thelbin dhe nevojën e standartizimit.

Grafiku 12. Ngarkesa e punonjesve te administrates dhe te punonjesve te sherbimit



Bashkia Durres, se fundmi eshte binjakezuar me bashkine Selanik. Edhe zona funksionale Selanik perbehet nga 6 njesi vendore sipas reformes se 2011, por keto vazhdojne te jene me buxhet dhe bilanc me vehte. Vete bashkia , pjese e ZF Selanik ka rreth 343 mije banore (durresi 208 mije), ajo ka nje buxhet prej 423 milion euro, jep PBB/fryme 17200 euro. Ngarkesat krahesuese jane :

Grafiku 13. Ngarkesa e punonjesve te administrates dhe te sherbimeve publike ne bashkine Durres dhe Selanik, nr/1000 banore



Persa i perket nivelit te kualifikimit, vihet re nje perqindje e larte e punonjesve me arsim te larte ne KiR dhe Durres.

Tab 56. Niveli i Edukimit te Punonjesve te FA Durres

Njesia Vendore	% e punonjesve me arsim te larte ne administrate	% e keshilltareve me arsim te larte
Durrës	60,4	90,0
Manëz	28,0	41,2
Ishëm	50,0	26,7
Katund i Ri	68,0	58,8
Sukth	14,0	28,0
Rashbull	32,3	56,0

VI.2. Buxhetet e NjQV te ZF Durres

Te gjashte njesite e zones funksionale te Durresit kane perfituar ALL 650,876 ne 2014 dhe kane te buxhetuar ne ligjin e ri fiskal 2015 nje shume totale prej ALL 591,898. Sic verehet transfertat e pakushtezuara per vitin 2015 oer ZF Durres, jane parashikuar me nje ulje totale prej rreth 9% sic dhe tregohet ne detaj ne tabelen e meposhteme.

Tabela 64: Transfertat e Pakushtezuara per Bashkite dhe Komunat e ZF Durres 2014 (fakt) & 2015 (plan)

	NjQV	Transfertat e Pakushtezuara 2014	Transfertat e Pakushtezuara 2015 (plan)
1	Durres	437,906	428,804
2	Manez	31,828	24,289
3	Sukth	69,480	57,460
4	Rashbull	56,808	41,340
5	Katund i Ri	32,083	23,398
6	Ishem	22,771	16,607

Burimi: Ligji i Buxhetit 2014, Nr. 185/2013 date 2.12.2013 dhe Ligji i Buxhetit 2015, Nr. 160/2014; Llogaritjet e autoreve

Ne se lexohet me kujdes tabela e mesiperme rezulton qe zona funksionale Durres, per vitin 2015 te kete nje burrim financimi nga trasfertat e pakushtezuara rreth 160 milion leke ose rreth 27% me pak se ne vitin 2014. Kjo mund te jete rrjedhoje edhe e veshtiresive financiare te qeverise qendrore, por ne thelb nuk qendron. Nderkohe qe realizon nje reforme te re minimalisht trasferta e pakushtezuar duhet te mbetet ne nivelin e vitit te kaluar per te ruajtur


nivelin e shërbimeve që janë me njësi individuale të ZF, në të kundërtë rënia e këtij niveli do parajykojë vetë epërsinë e reformës për rritje të cilësisë së shërbimeve ndaj komunitetit.

Tab 65. Perberja e të Ardhurave 2013 – ZF Durrës (ALL .000)

Njesia Vendore	Gjithsej buxheti i pavarur 2013 (000/ leke)	Nga :		Raporti në % i të ardh. Vendore / buxh. Tot.
		Granti 2013 (000/ leke)	Te ardhura vendore në 000/leke	
Durrës	1,464,234	360,234	1,104,000	75.4
Manëz	42,021	29,521	12,500	29.7
Ishëm	171,085	21,085	150,000	87.7
Katund i Ri	64,256	31,038	33,218	51.7
Sukth	109,455	62,129	47,326	43.2
Rashbull	179,752	54,752	125,000	69.5

Burimi: Ministria e Financave, NjQV respektive, llogaritjet e autoreve

Grafiku 14. Te ardhurat e NJQV (2013)



Burimi: Ministria e Financave, NjQV respektive, llogaritjet e autoreve


Me një mesatare si zone funksionale prej 68.4%, të raportit të të ardhurave të veta ndaj totalit të të ardhurave në dispozicion, kjo mund të konsiderohet si **zona funksionale me eficientë në shkallë vendi**.

Tab 66. Perberja e shpenzimeve ZF Durres - 2013 (ALL .000)

Njesia Vendore	Shpenzime administrative ne 000/leke (F.Page+Sig shoq.+ Sh. Operative)	Shpenzime per 1000 banore (000/leke)	Raporti i shpenz. dhe te ardhurave (F.p. + sig + shp.op.) ne % ndaj tot. Shpenz.	Ngarkesa e administrates (numri i punonjeseve) per 1000 banore	Investime ne % / buxhetit te pavarur
Durrës	156,977	754	45.3	1,2	14.2
Manëz	19,473	1,699	74.6	4,4	78.7
Ishëm	21,512	2,418	15.3	4,7	47.7
Katund i Ri	13,256	851	48.5	1,6	63.3
Sukth	34,822	1,297	31.8	3,2	51.7
Rashbull	46,960	1,612	43.9	3,3	46.3

Burimi: Ministria e Financave, NjQV respektive, llogaritjet e autoreve

Grafiku 15. Shpenzimet e NjQV (2013)



Burimi: Ministria e Financave, NjQV respektive, llogaritjet e autoreve

Por dukuria pozitive e nenvizuar me lart ne eficensen ekonomike te njesive te ZF Durres, nuk I pergjigjet plotesisht edhe eficiences financiare te shprehur grafikisht me siper.


Ne pamje te pare duket qe per investime kapitale shkojne perafersisht rreth 57% dhe per shpenzime operative dhe paga rreth 43%, por ne se nga shpenzimet kapitale c'vishet pjesa e investuar drejtperdrejt nga qeveria qendrore ose donatoret, te cilat aktualisht paraqiten e llogariten ne nje tregues dhe qe zene gati 62% te investimeve kapitale, atehere del me mire ne pah se shpenzimet per paga dhe operative kane pjesen e "luanit" ne totalin e te ardhurave.

Tab 67. Raporti mes buxheteve të NJQV-ve me mesataren e buxheteve të NJQV-ve të qarkut Durrës

Qarku Durrës		TR/ATR		
		2011	2010	2009
Durrës	B	826%	996%	798%
Manëz	B	35%	29%	55%
Sukth	B	78%	63%	76%
Rashbull	K	114%	90%	96%
Katund i Ri	K	46%	45%	38%
Ishëm	K	26%	22%	34%

Burimi: Ministria e Financave, NjQV respektive, llogaritjet e autoreve


Grafiku 16. Buxhetet e NjQV: 2011-2014



Burimi: Ministria e Financave, NjQV respektive, llogaritjet e autoreve

Duke analizuar buxhetet e vitit 2015, veme re se pesha specifike e zones funksionale Durrës, kundrejt mesatares se viteve 2011-2014 eshte ulur nga 58% ne 53.2%. Ulje kane pasur te gjitha njesite e zones, por me sa duket ketu ulja ka qene me e theksuar se pjeset e tjera te qarkut Durrës.

Grafiku 17. Buxheti i ZF Durres / Qarku Durres 2015



Burimi: Ministria e Financave, NjQV respektive, llogaritjet e autoreve

Tab 68. Të ardhurat e veta të NJQV-së për banor krahasuar me mesataren e të ardhurave të veta të NJQV-ve ne Shqiperi

Qarku Durrës	OSR / AOSR për frymë		
	2011	2010	2009
Durrës	149%	152%	180%
Manëz	39%	51%	35%
Sukth	39%	43%	41%
Rashbull	179%	164%	173%
Katund i Ri	58%	99%	22%
Ishëm	35%	54%	102%

Burimi: Ministria e Financave, NjQV respektive, llogaritjet e autoreve

Tab 69. Shpenzimet totale të NJQV-së për banor krahasuar me mesataren në nivel vendi të shpenzimeve / banor

Qarku Durrës	TE / ATE për frymë		
	2011	2010	2009
Durrës	139%	135%	81%
Manëz	51%	62%	120%
Sukth	68%	59%	66%
Rashbull	122%	102%	101%
Katund i Ri	89%	79%	65%
Ishëm	117%	98%	288%

Burimi: Ministria e Financave, NjQV respektive, llogaritjet e autoreve

Eshte normale qe taksa paguesit me te shumte jane ne Durres (ndonese dhe popullsia aty eshte me e madhe), por disproporcioni me Rashbullin ne masen 60%, kur dihet intesiteti i zines se

Rashbullit, tregon per neglizhence ne grumbullimin e tyre, ashtu sikunder eshte e pajustificuar edhe nga vrojtimi i lire qe Ishmi te mbledhe gati 4 here me shume se Katundi i ri.

Po me kete llogjike mund te komentohen edhe dipropocionalitetet ne kontributi ne taksa e pasurise, por vecse ketu vihet re ashtu sic duhet te jete normalisht nje nivel i perfert midis B.Durres dhe K.Rashbull e per te qene me te sakte ne kete rast del me e prapambetur (neglizhente) B.Durres, sikunder lexohet ne tabellen 58.

Tab 70. Të ardhurat nga taksat e pasurisë për banorë sipas NJQV-ve të qarkut Durrës, krahasuar me mesataren kombëtare / banor

Qarku Durrës	Taksa e pasurisë/banor			
	2008	2009	2010	2011
Durrës	6,04	5,51	5,17	5,48
Manëz	0,66	0,73	0,69	0,73
Sukth	0,71	0,74	0,95	0,92
Rashbull	4,84	5,22	5,61	6,63
Katund i Ri	0,62	0,25	1,37	1,16
Ishëm	1,60	2,19	4,88	3,71

Burimi: Ministria e Financave, NjQV respektive, llogaritjet e autoreve

Analiza me e hollesishme ne kete drejtim, si per gjithe njesite edhe per zonen funksionale Durres, tregon se rezerva kryesore dhe burimi decizif i te ardhurave ne te ardhmen mbeten taksa e pasurise dhe tokes.

VI.3. Strategjite e Zhvillimit dhe te Integritimit 2014 – 2020 & Plane e Zhvillimit Vendor

VI.3.1. Perputhshmeria me strategjite sektoriale 2014-2020

Sektorët e identifikuar me siper jane ne pergjithesi ne perputhje me objektivat kombetare strategjike te parashikuara per zhvillimin e tyre nga qeveria shqiptare.

Keshtu, ne draft “Strategjine zhvillimit të biznesit dhe investimeve për vitet 2014-2020” Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtise dhe Sipermarrjes percakton si nje prej objektive te saj per zhvillimin e industrise perpunuese “Objektivi 2.2.3: Fuqizim dhe diversifikim i mëtejshëm i operacioneve të përpunimit aktiv (fason)”. Ne kete dokument strategjik percaktohet se “Arritja e këtij objektivi do të realizohet nëpërmjet mbështetjes financiare për ndërtimin e kapaciteteve njerëzore, për prodhuesit e tekstileve dhe të këpucëve, për të krijuar ndërmarrje të pavarura dhe eksportues direkt. Gjithashtu qeveria do të stimulojë diversifikimin e përpunimit aktiv në sektorë të tjerë, siç janë produktet mekanike, ose montimet e nyjeve apo pajisjeve elektronike duke tërhequr prodhues të teknologjisë së larte.”

Ne *Strategjine per Menaxhimin e Financave Publike 2014 – 2020* (pp. 34, 53 e tutje) shpjegohen ne detaj modalitetet e bashkerendimit te financave te pushteit vendor pas hyrjes ne fuqi te reformes adminsitartive dhe territoriale dhe startegjise se decentralizimit.

Persa i perket zhvillimit trasportit dhe magazinimit nuk evidentohen asnje dokument strategjik aktual i cili mund te detajoje drejtime planifikimi afatmesem ne lidhje me kete sektor.

Lidhur me sektorin akomodim dhe gastronomi/turizem “Draft-Strategjia e Zhvillimit të Turizmit në Shqipëri 2014-2020” pergatitur nga Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit e cila eshte ne proces rishikimi percakton kater fusha kryesore strategjike te llojeve të turizmit dhe produkteve turistike që do të krijohen ne vitet a ardhshme. Konkretisht, ne kuader te drejtimi strategjik 1.2: Turizmi kulturor, kjo strategji planifikon te “Përmirësohet oferta për turizëm kulturor dhe në destinacionet turistike ekziston një gamë e gjerë produktesh dhe atraksionesh turistike zbavitëse dhe të marketueshme të turizmit kulturor. Pikat turistike dhe ofertat për turizëm kulturor janë të mirënjohura dhe të konsoliduara në tregjet kryesore të burimeve.” Gjithashtu, drejtimi strategjik 1.3: Turizmi i natyrës dhe rural ka si synim te “Zhvillohet turizmi i natyrës dhe rural. Në destinacione të përzgjedhura me potenciale natyrore tërheqëse dhe fshatra tradicionale me një mënyrë jetese autentike ekziston një gamë tërheqëse produktesh turistike me interes të veçantë. Ofertat për turizëm të natyrës dhe rural janë të mirënjohura dhe të konsoliduara në tregjet kryesore të burimeve”.

Ne dokumentin e *Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2014 – 2016*, FA Durres permendet si destinacion investimesh ku me kryesoret jane:

- Porti Detar: Zhvillimi i Portit te Durresit sipas modelit Land - Lord Port (Port Administrues Toke) dhe ndertimi e terminaleve te perpunimit te konteinereve me koncesion etj; Komercializimi i portit & privatizimi i sherbimeve; Reabilitimi i Infratruktures dhe Superstruktures se Portit Detar Durres, rreth 85 per 2016 %; dhe ndertimit te Portit te peshkimit ne Durres;
- Infrastruktura rrugore: rruga lidhese Porto Romano – Durres; Bypassi Plepa – Kavaje dhe Plepa – Rrogozhine; rruga A. Goga – ish Ndermarrja Kimike; byPass i Shkozetit; rikonstruksion i Unazes se Qytetit; Studim-projektim per mbylljen e vend-depozitimeve ekzistuese te mbetjeve te ngurta ne Durres;
- Mbetjet & KUZ: Reabilitimi i fushes ekzistuese te mbetjeve te ngurta Durres & Fillimi i punimeve per reabilitimin i fushave ekzistuese te mbetjeve te ngurta; Impianti i pastrimit te Durresit siper 30 ha vler 11 milion Euro sasia e tratimit 700 l/sek. Perfundimi dhe kolaudimi i tre objekteve Durres, Kanalizime "Ndërtimi i rrjetit kryesor të KUZ-së në zonën e plazhit Durres (Perroi i Agait Ura e Dajlanit) dhe linja e dergim; Furnizimi me uje i plazheve Durres – Kavaje nga burimet e Yermes Loti II; etj.

Gjithashtu ne mbledhjene saj date 14 Shkurt 2015, Kështu, qeveria ka miratuar tri projekte me vlera të konsiderueshme për Bashkinë e Durrësit. Më konkretisht, për këtë bashki qeveria ka dhënë plot 250 milionë lekë reja vetëm për projektin e zgjerimit të bulevardit “Pavarësia” dhe bërjen e rrugëve hyrëse në plazh. Gjithashtu, për Durrësin janë miratuar edhe dy projekte për fasadat e pallateve dhe vënien në funksion të pishinës kryesore të qytetit. Për të dyja këto projekte qeveria ka dhënë edhe 100 milionë lekë të tjera të reja, per nje total qe shkon ne ALL 350 MIO.

VI.3.2. Lista e planeve strategjike te NJA-ve

Ne pergjithesi bashkite dhe komunat e ZF Durres kane dokumente studimore te cilet analizojne profilet etyre dhe tregojne skenaret per zhvillimin ne te ardhmen. Sdq, pervec Bashkise Durres qe ka nje panopli me se te plote dhe koherente, NjQV e tjera kane dokumente pjesore dhe qe ne shumicen e rasteve po u afrohen afait te skadences qe eshte 2015.

Ne vecanti:

- Bashkia Durres dhe Komuna Ishem kane nje plan te aprovuar te territorit

- Bashkia Durres, Komuna Ishem dhe Komuna Rrashbull kane nje plan zhvillimi ekonomik zyrtar. Bashkia Sukth ka nje analize studimore mbi ekonomine dhe transportin.
- Vetem Bashkia Durres ka nje plan lokal te menaxhimit te mbetjeve te aprovuar.
- Vetem Bashkia Durres ka nje Vleresim Strategjik Mjedisor;
- Bashkia Manez ka pergatitur planin e rregullimit urban (perfshire dhe Landillin) por nuk e ka te aprovuar.

Me poshte po perendim disa projekte madhore me interes per ZF

Durres. Zona e Spitalles ne nje siperfaqe prej 850 ha do te kthehet ne Zone Industriale – Zone e Tregetise se Lire. Dokumenti eshte duke u pergatitur nga AIDA dhe se shpejti pritet te dale VKM perkatese.

Katund i Ri. Kjo zone përfshin territore të pafavorizuara nga ana natyrore dhe ekonomike, siç është toka jo prodhuese agrikulturore e ndotur nga ish Fabrika kimike në Durrës dhe e prekur nga erozioni i detit. Bazuar në anën administrative është pjesë e komunës së Katundit të Ri dhe zona e zgjedhur konsiston në një siperfaqe prej 1,367ha ku 810 hektarë janë për Parkun Energjitik. Si territore të pafavorizuara përfshihen 1166 hektarë tokë jo pjellore agrikulturore, 45 hektarë zone pylli, 114 hektarë tokë rajonale, dhe 42 ha ndertesa dhe në tërësi zona karakterizohet nga vënde kënetore me cilësi shumë të dobët. Qendra e zgjerimit të parkut industrial energjitik është zona e depozitës së karburantit në Porto Romano, e kundërta, që është, ndërtuar vendi për përpunimin e anijeve tank që transportojnë naftë, gaz dhe produktet e tyre.

Parku Biologjik. Ky model zhvillimi, nëse aplikohet shpreh potencialet e tij në një zone jo të favorshme, pa bimësi, me tokë jo produktive, të ekspozuar në erosion dhe në efekte shkatërruese të natyrës për shkak të mosndërrhyrjes të përshtatshme dhe në kohë me investimet e duhura. Zona ku projekti pritet të zbatohet konsiston në një territor me lagështi midis rripit të rërës dhe rripit të parë të pishës përgjatë pothuajse të gjithë vijës bregdetare të Ishem-Porto Romano. Sipërfaqja ku ky project zhvillimi do të aplikohet përfshin një territor të sheshtë jo produktiv prej 382 ha⁴, kufizuar në Veri nga grykderdhja e lumit Erzen, në Perëndim 150 m nga rripi i rërës, në Lindje nga rripi i parë i pishës. Kjo zonë është zgjedhur për tu transformuar në një zonë intensive, sociale, ekonomike dhe zhvillimit mjedisor. Avantazhi i kësaj vendodhje konsiston në kushtet klimatike të favorshme, pozicionin gjeografik dhe daljen në detin Adriatik.

Ishem. “Lalzi Bay Resort and SPA” e zbatueshme në zonën bregdetare vendosur në territore rurale dhe jo të favorshme është Resorti i “Lalzi Bay Resort and Spa”. Ky resort po ndërtohet pranë gjirit të Lalzit në Hamallaj. Ky projekt nën Master Planin për zhvillimin e turizmit në Lalzi Bay pranë fshatit turistik të ndërtuar ose në proces ndërtimi siç është “Lura”, “Peshkatari”. Një numër I konsiderueshëm banorësh do të punësohet direkt ose indirekt si projekti do të mundësoj zhvillimin e aktiviteteve të tjera ekonomike veçanërisht bujqësisë dhe fermerisë që do të ofrohen me produktet e tyre.

Harta 14: Harta e Menaxhimit te Territorit Ishem – Porto-Romano



COOPERATION AND DEVELOPMENT INSTITUTE



Manez

Plani i zhvillimit është fokusuar në zhvillimin e Landfillit, ndertimin e një kompleksi kulturor-sportivo-artistik, dhe në ndertimin e një zone moderne shërbimesh në kufi me plazhin e Lalzit.

Bibliografi shtese

1. http://www.instat.gov.al/media/247026/regjistri_ndermarrjeve_2013.pdf
2. http://www.instat.gov.al/media/198058/regjistri_ndermarrjeve_ekonomike-2012.pdf
3. http://www.instat.gov.al/media/204741/llogarit_rajonale_n_shqip_ri_2011_final.pdf
4. http://www.instat.gov.al/media/251556/llogarit_rajonale_n_shqip_ri_2012.pdf
5. Buletini i Tregut të Punës, ShKP 2013
6. PERFUNDIME TE ANKETIMIT DHE TAKIMEVE ME BIZNESIN PER REFORMEN TERRITORIALE ADMINISTRATIVE, KONFINDUSTRIA-PROJEKTI STAR, QERSHOR 2014
7. Strategic Plan for Economic Development 2005 - 2015, Municipality of Durres, by FLAG
8. Plani i Zhvillimit te Turizmit. Komuna Ishem, FShZH, ISB , Qershor 2009
9. Development Alternatives in Rural and Unfavourable Areas in the Coastal Area of Ishem-Porto Romano for a Sustainable Development, M .Sc. Shkëlqim Sirika, Academic Journal of Interdisciplinary Studies, Oct. 2013
10. Towards a Sustainable Development of the Tirana – Durres Regions. Reginal Development Study for the Tirana – Durres region, by GTZ and Institute of Ecological & Regional Development, Dresden, Tirana 2002
11. Projekti i Programit Buxhetor Afatmesëm 2014- 2016, Ministria e Financave, Dhjetor 2014
12. Buletini Statistikor 2013, Bashkia Durres
13. Buxheti i Bashkise Durres, 2014
14. Politikat sektoriale SKZHI 2014 – 2020, Repository i Politikave Publike, Shtetweb.org
15. Libri i Biznesit, Dhome e Tregetise dhe Industrise, Durres
16. KUZ Performance Report 2013
17. Projektet KUZ ne Zonen e Durresit: <http://www.dpuk.gov.al/qytet.php?id=5&l=1>
18. AKPT
2013: http://planifikimi.gov.al/sites/default/files/Raporti_Vjetor_formatA4.pdf;
19. Plani i Zhvillimit Tirane - Durres ne: <http://planifikimi.gov.al/content/plani-tirane-durres-ptd>;
20. Plani i Integruar Nder-sektorial per Bregdetin: <http://planifikimi.gov.al/content/plani-i-integruar-ndersektorial-per-bregdetin-pis>
21. FShZh (rruget e financuara nga FShZh) : http://www.albaniandf.org/Resources/Publikime/Raporte/Raporti_vjetor_2013_final.pdf
22. *Kryeministri qe ka Nostalgi per Adem Reken*, Gazeta Tema 24 Dhjetor, ne <http://www.gazetatema.net/web/2014/12/24/kryeministri-qe-ka-nostalgi-per-adem-reken/>
23. WATER RESOURCES AND IRRIGATION PROJECT, Project ID No. P121186, Loan No.: IBRD 82110
24. “Forumet Urbane, Peleshi në Lezhë: Qeveria ofron asistencë teknike dhe financiare për hartimin e projekteve”, gazeta SOT 21 nentor 2014, at: <http://www.sot.com.al/politike/forumet-urbane-peleshi-n%C3%AB-lezh%C3%AB-qeveria-ofron-asistenc%C3%AB-teknike-dhe-financiare-p%C3%ABr-hartimin#sthash.olQsXRnd.dpuf>

25. Strategjia kombëtare sektoriale e shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve 2011-2017, Ministria e Punëve Publike dhe Transportit
26. Environmental Impact Assessment Report, Draft for consultation, Ministry of Public Works and Transport
27. KUZ Durres - Praktika e matjes së Konsumit, Ing. Edlira HYSA
28. Projektligji PËR ADMINISTRIMIN E UJITJES DHE KULLIMIT
29. Results of consultative meetings with LGUs Functional Area Durrës, October - November 2014
30. Turizmi fetar, risia shqiptare, 21 Nentor 2014, Gazeta Tema
31. ACTION PLAN FOR DURRES FUNCTIONAL AREA
32. DLDP ACTION PLAN FOR DURRES FUNCTIONAL AREA
33. Report Durrës District, Second delineation of the functional areas
34. The Functional Area Programme- Focus on the Functional Area Analysis, Tirane, October 3d , 2014.
35. Haxhinasto: Prioritare linja hekurudhore Tiranë-Rinas-Durrës | GAZETA DITA 07/10/14
36. Strategjia per Menaxhimin e Financave Publike 2014 - 2020 (pp. 34, 53 e tutje), REPO Shtetiweb.org
37. Strategjia Sektoriale te Zhvillimit te Bizneseve & Investimeve 2014 - 2020, REPO Shtetiweb.org
38. KUZ Durres Pasqyrat Financiare 2012.
39. KUZ Durres Pasqyra Financiare te Audituarra per Periudhen Kontabel e mbyllur me 31 Dhjetor 2013, se bashku me Raportin e Audituesit